

Enti Rregullator i Ujit



RAPORTI VJETOR

2020

Tiranë
Janar 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2020

**VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME**

JANAR, 2021

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Parathënie	3
Përmbledhje	6
1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	14
1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.....	14
1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”	15
1.3 Struktura Organizative e ERRU-së	15
1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese	16
1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK	16
1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor	19
1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	22
1.4.4 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve	25
1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK	27
1.4.6 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore	27
1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së	29
1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	29
1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare	30
1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median	32
1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së	33
1.7.1 Të Ardhurat	33
1.7.2 Shpenzimet Operative	34
2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2020	36
3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi	43
4 Gjendja në Sektorin e Ujësjetës Kanalizime	45
4.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2020	45
4.2 Subvencionet dhe Debitë ndaj OSHEE-së	50
5 Situata në Zbatim të Reformës në Sektorin e Ujit	51
6 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2021	53
7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit	54
Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2020	55
Aneks 2 - Tarifat aktuale për Shërbimin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujërave të Ndotura ..	57
Aneks 3 - Shoqëritë e riorganizuar dhe të licencuara sipas reformës	58
Aneks 4 - Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2020	59
Aneks 5 - Subvencionet nga Qeveria për Shoqëritë UK, Viti 2020	60

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
U	Ujësjiellës
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
SHUKALB	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Kosovës
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
NER	Rrjeti i Rregullatorëve Ekonomik
ERSAR	Rregullatori i Portugalisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
BE	Bashkimi Evropian
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
UPA	Uji Pa të Ardhura

Parathënie

Enti Rregullator i Ujit harton Raportin Vjetor 2020, i cili pasqyron aktivitetin dhe performancën e këtij institucioni në përmbushje të detyrimeve që ngarkon ligji si edhe përmbushjen e rekomandimeve të cituara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për ERRU-në për tu realizuar gjatë vitit 2020.

Pjesa e dytë e Raportit paraqet zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri, performancën e sektorit dhe të grupeve të shoqërive UK, përfshirë dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës në të ardhmen.

ERRU gjatë aktivitetit të tij në vitin 2020 si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit të UK, me gjithë vështirësitë e krijuara nga pandemia e COVID 19 ka rritur përpjekjet në mbështetje të përmirësimit të performancës. ERRU ka rritur kërkesat ndaj operatorëve në mënyrë që ato të rrisin cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe të propozojnë tarifa të përballueshme financiarisht. Nga ana tjetër, ERRU thekson nevojën e përmirësimit të aspekteve të menaxhimit nga shoqëritë në mënyrë që ato të jenë të qëndrueshme financiarisht, si dhe gjatë aktivitetit të tyre të jenë sa më transparente me publikun.

Viti 2020 ka qenë vit i vështirë në drejtim të operimit të sistemeve të ujësjellës kanalizimeve sidomos gjatë periudhës Mars - Maj gjatë së cilës ishte pothuaj një mbyllje totale e lëvizjes së njerëzve dhe aktiviteteve. Fatmirësisht virusi COVID 19 rezultoi që nuk përhapej me anë të ujit, por gjithsesi pandemia krijoi problematika në drejtim të organizimit të njerëzve dhe me mjete mbrojtëse kundër përhapjes së virusit, të dezinfektimit të ambienteve dhe sigurimit të lëvizjes së punonjësve duke i pajisur ato me leje të posaçme nga autoritetet.

Vështirësia e pritshme që u vu re kryesisht gjatë 6 muorit të parë të vitit ishte rënia e arkëtimeve nga pamundësia e pagesës së faturave nga konsumatorët familjarë, por edhe në përgjithësi të rënies së performancës financiare të shoqërive sepse pandemia rriti nivelin e papunësisë dhe të numrit të familjeve si kategori të shtresës me ndihmë ekonomike.

Pavarësisht kësaj situate ERRU ka vazhduar aktivitetin e saj, por duke marrë masat e duhura për të punuar online dhe njëkohësisht duke respektuar udhëzimet dhe aktet nënligjore të nxjerra nga qeveria për masat mbrojtëse për personelin në lidhje me dezinfektimet dhe respektimin e distancës sociale në ambientet e punës. Aktiviteti i ERRU gjatë vitit 2020 ka qenë kryesisht në këto tematika kryesore:

- Licencime të Shoqërive UK
- Miratim i tarifave të reja të propozuara nga Shoqëritë UK
- Trajtim i ankesave të konsumatorëve
- Pjesëmarrje me platforma online në seminare, konferenca dhe takime pune në nivel institucional kombëtar dhe ndërkombëtar
- Raportime dhe analiza mbi aktivitetin ekzekutiv të ERRU-së, etj.

Gjatë vitit 2020, ERRU ka analizuar aplikimet dhe ka nxjerrë vendimet përkatëse për tarifa të reja për katër shoqëri UK, përkatësisht UK Pogradec, UK Fier, UK Peqin dhe UK Patos, ndërsa ka marrë në shqyrtim kërkesën për licencim, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, teknik si dhe përfundim të afatit të licencës së mëparshme për 21 shoqëri UK.

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja ERRU i ka kushtuar vëmendje kryesore me analiza mjaft komplekse veçanërisht propozimeve të shoqërive UK Pogradec dhe UK Patos, përkatësisht me

specifika, e para aplikonte për herë të parë për tarifa volumore me një bllok, ndërsa e dyta aplikonte për herë të parë, por me mjaft probleme në drejtim të kostove të energjisë elektrike dhe të një performance financiare mjaft të ulët. Në të dyja analizat, ERRU ka vendosur për të ardhmen objektiva ambicioze për shoqëritë në drejtim të përmirësimit të treguesve kryesore të performancës, si në aspektet financiare të uljes së kostove të punës dhe të energjisë, edhe të cilësisë së shërbimit ndaj klientëve.

Konstatohet se për shoqëritë UK dhe për sektorin në përgjithësi mbetet si sfida kryesore rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë elektrike, ndërtimi i një organograme efikase dhe me njerëz që justifikojnë vendin e punës në to, si edhe agregimi për të rritur efikasitetin nëpërmjet ekonomisë së shkallës.

Gjatë vitit 2020 ERRU i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit dhe pasurimit të instrumenteve rregullatorë, sidomos ato që lidhen me analizat e qëndrueshmërisë financiare, të diagnostifikimit dhe përcaktimit të rrugëve për uljen e humbjeve dhe Ujit Pa të Ardhura, si dhe të përmirësimit të punës për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, si bonus apo penaltet për shoqëritë UK. Në këtë kuadër përmendim, studimet dhe raportet, si më poshtë:

- “Studimi për Familjet me Ndhmë Ekonomike dhe Influenca në Qëndrueshmërinë Financiare të Shoqërive UK ”
- “Hartimi i Raportit të Bilancit të Ujit për vitin 2020”, për çdo shoqëri UK dhe sektorin në përgjithësi, ku jepen orientime dhe rekomandime për hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike.
- Hartimi i Raportit të Monitorimit për Ankesat e konsumatorëve ndaj Shoqërisë UK Tiranë, si model praktike e unifikuar monitorimi në të gjitha shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t’u ankuar nëpërmjet një procedure korrekte ligjore, dhe që trajtimi i këtyre ankesave të gjejë një zgjidhje praktike dhe sa më të drejtë nga ana e shoqërive UK. Raporti përmban praktika dhe rekomandime përgjithësuese që do të aplikohen në të gjitha shoqëritë UK në lidhje me trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

ERRU ka intensifikuar marrëdhëniet bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, me Njësinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Autoritetin e Konkurrencës në mbrojtje të interesave të konsumatorëve.

ERRU në kushtet e pandemisë ka vazhduar bashkëpunimin virtual me WAREG (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit), ku ERRU është anëtare me të drejta të plota, Programin e Danubit financiar nga Banka Botërore, IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit), si dhe marrëdhëniet dypalëshe kryesisht me rregullatorin e Kosovës dhe atë të Italisë ARERA.

Raporti jep gjithashtu edhe një pasqyrim të situatës aktuale të sektorit. Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2020 tregojnë se gjendja në sektor në krahasim me vitin 2019 paraqet një përkeqësim në drejtim të treguesve të Ujit Pa të Ardhura, Mbulimit të Kostove Direkte të O&M, Normës së Arkëtimit, si dhe treguesit Mbulimi me FU. Treguesi Mbulimi me Kanalizime ka mbetur në të njëjtin nivel ndërkohë që ka përmirësim në treguesit e tjerë si Niveli i Matjes, Kohëzgjatja e FU, si dhe Efienca e Staf/1000 lidhje UK.

Përgjithësisht përkeqësimi i gjendjes së sektorit shpjegohet me pasojat nga pandemia COVID 19, si dhe vazhdimësinë e atyre të tërmetit të fuqishëm të ndodhur në fund të vitit 2019.

Në këtë raport ndryshe nga vitet e tjera nuk janë trajtuar investimet e realizuara në sektor për vitin 2020 për shkak të mungesës së informacionit që duhej të vihej në dispozicion nga AKUM.

ERRU edhe më tej do të rrisë përpjekjet për një angazhim akoma më ambicioz në përmbushje të rolit të tij si institucion i pavarur që me profesionalizëm, transparencë dhe në bashkëpunimin ndërinstitucional të arrijë të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.

Komisioni Kombëtar Rregullator

Përmbledhje

**Raporti Vjetor
2020 i
Aktivitetit të
ERRU-së
Instrument
Informimi dhe
Transparence**

Misioni i ERRU-së si institucion i pavarur i krijuar me ligj është "*Të sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që operatorët e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ti ofrojnë ato me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme*".

Raporti Vjetor 2020 i aktivitetit të ERRU-së, si detyrim ligjor i institucionit të ERRU-së për hartimin e tij, përcakton në mënyrë të detajuar aktivitetin e tij në përmbushje të misionit të tij, si edhe objektivat e punës në të ardhmen për forcimin e rolit të tij si institucion i pavarur. Në një kapitull të veçantë raporti analizon gjendjen dhe performancën e sektorit të ujit, si dhe jepen rekomandime për rritjen e performancës së tij në të ardhmen.

Nga ana tjetër qëllimi i Raportit është informimi dhe transparencja ndaj Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrit, si dhe ndaj publikut dhe institucioneve që lidhen me sektorin e ujit.

**ERRU, Statusi
Ligjor dhe
Përgjegjësitë**

Baza kryesore ligjore e ushtrimit të aktivitetit të ERRU-së si institucion i pavarur është ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Ky ligj e ngarkon ERRU-në me përgjegjësitë e licencimit, vendosjes së tarifave të shërbimeve UK si dhe me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve për garantimin e shërbimeve cilësore nga shoqëritë UK.

**Licencimi i
Shoqërive UK**

Situata e licencimit për të 57 shoqëritë UK, rezulton:

- 49 shoqëri UK disponojnë licenca të vlefshme, ndërsa për 8 të tjerat gjendja është si më poshtë;
- Shoqëritë UK Tiranë dhe Selenicë janë në proces për rinovim të licencës pranë ERRU-së. UK Tiranë e cila pritet që të mbulojë me akt-miratimin higjieno – sanitar të gjithë zonën e shërbimit që edhe këtë vit e ka patur të pamundur ta realizojë atë për shkak të gjendjes së pandemisë.
- Shoqëritë UK Divjakë, Has dhe Lushnje operojnë me licencë të pavlefshme, Divjaka nuk ka kryer reflektimet përkatëse pranë QKB, UK Lushnje dhe UK Has i kanë mbaruar afati i licencës në korrik 2020, por akoma nuk kanë aplikuar për rinovim licence edhe pas njoftimeve dhe masave penalizuese nga ERRU.
- Shoqëritë UK Kamëz, UK Klos dhe UK Pustec ende nuk janë pajisur me licencë, pasi nuk arrijnë të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar për licencim, kryesisht për problematiken e marrjes së Akt-Miratimit Higjieno Sanitar.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar zgjidhjen e problematikave të hasura për licencimin e shoqërive duke ngritur shqetësimin pranë MIE dhe ISHS mbi nevojën e rishikimit të akteve nënligjore që kushtëzojnë kërkesat për emërimin e drejtuesve teknikë, veçanërisht për shoqëritë e vogla si dhe për të vendosur ligjërisht në kushte më praktike procesin e marrjes së Akt Miratimit Higjieno Sanitar.

**Procesi i
Miratimit të
Tarifave për
Shërbimet UK**

Gjatë vitit 2020 ERRU ka miratuar tarifa për 5 shoqëri UK, ku për tre prej tyre është mbyllur procedura deri në vendimmarrje brenda vitit 2020 përkatësisht për UK Pogradec, UK Peqin dhe UK Fier. UK Patos është në fazën përfundimtare ku analiza e tretë ka kaluar në KKRR dhe vendimmarrja përfundimtare do të jetë në fillim të janarit 2021, ndërsa për shoqërinë UK Sarandë është marrë vendimi nga KKRR për fillimin e procedurës për tarifat e reja pasi i gjithë dokumentacioni i aplikimit të paraqitur nga shoqëria rezultoi i rregullt.

Aplikimet kanë patur si arsye kryesore unifikimin e tarifave në të gjithë zonën e re të shërbimit si pasojë e rritjes së saj pas reformës territoriale, si dhe për rritjen e të ardhurave për të mbuluar Kostot Direkte e Totale të shërbimeve UK. Procesi i miratimit të tarifave nga ERRU shoqërohet me analiza të hollësishme që marrin në konsideratë vetëm kostot e arsyeshme dhe të justifikuara, të cilat duhet të jenë të lidhura ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve dhe të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve. Gjithashtu në miratimin e tarifave ERRU përdor kriterin e përballueshmërisë së pagesës së faturës nga konsumatorët i cili aktualisht është 5% e shpenzimeve mesatare mujore për familje.

UK Pogradec ka aplikuar në Prill 2020, ku u kalua nga tarifa volumetrike për shërbimet UK me dy blloqe konsumi, në sistemin tarifor me një nivel ose bllok tarifë volumetrike për secilin shërbim për të mbuluar mbi 100% të kostove të operim mirëmbajtjes dhe mbulimit të një pjesë të mirë të kostove totale.

UK Peqin ka aplikuar në Korrik 2019, ku synimi kryesor ishte rritja dhe unifikimi i tarifave për të gjithë zonën e shërbimit për të dy shërbimet atë të FU dhe shërbimin e KUN. Tarifat e reja synojnë rritjen e performancës financiare të shoqërisë duke ju afruar treguesit të mbulimit të plotë prej 100% të kostove të operim mirëmbajtjes.

UK Fier ka aplikuar në Shkurt 2020 me qëllim unifikimin e tarifave në përputhje me kërkesat e ristrukturimit të shoqërisë nga reforma për zonat e reja që janë shtuar në juridiksionin e shoqërisë me atë të zonës ekzistuese, tarifa që do të sjellin gjithashtu një përmirësim të mëtejshëm të situatës financiare të shoqërisë UK Fier.

UK Patos ka aplikuar në Tetor 2020. Shoqëria UK Patos aplikon për herë të parë për tarifa të reja pranë ERRU-së. Kjo është një nga shoqëritë me performancë mjaft të dobët financiare, si rezultat i kostove mjaft të larta, veçanërisht ato të energjisë elektrike. Tarifat e reja të propozuara synojnë rritjen e performancës financiare të shoqërisë edhe në kuadër të riorganizimit të saj për të mbuluar të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Patos. Shoqëria aplikon gjithashtu për herë të parë për konsumatorët tarifa shërbimi për largimin e ujërave të ndotura, shërbime që më parë ofroheshin dhe financoheshin direkt nga Bashkia Patos. Aktualisht është hartuar dhe shqyrtuar nga KKRR analiza përfundimtare e propozimit të shoqërisë për tarifa të reja. Vendimi përfundimtar pritet të merret në mbledhjen e parë të KKRR në Janar 2021.

**Trajtimi i
Ankesave të
Konsumatorëve**

Trajtimi i ankesave të konsumatorëve ka qenë në fokusin e punës së rregullatorit me qëllim që marrëdhënia kontraktuale Shoqëri UK - Konsumator të jetë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, dhe të garantojë cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

Për shkak të pandemisë viti 2020 ka qenë i vështirë për të mundësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e duhur me konsumatorët, si dhe stafet përgjegjëse të shoqërive UK për Marrëdhëniet me Konsumatorin. Kjo gjë ka influencuar edhe në numrin e ulët të ankesave (9) nga konsumatorët familjarë që Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit pranë ERRU ka trajtuar gjatë vitit 2020.

Natyra e ankesave të drejtuara pranë ERRU-së ka qenë mbi “faturimin aforfe”, “zbatueshmërinë e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime” dhe “cilësinë e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK”.

Gjithsesi ERRU ka rritur cilësinë e punës në mbrojtje të interesave të konsumatorëve duke hartuar me strukturë përgjithësues raporti monitorimi të ankesave të konsumatorëve për shoqërinë UK Tiranë, e cila do të përgjithësohet për të gjithë shoqëritë UK.

**Përmirësimi i
Standardeve në
Sektorin e UK
Nëpërmjet
Instrumenteve
Rregullatore**

Gjatë vitit 2020 ERRU, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit dhe pasurimit të instrumenteve rregullatore, sidomos ato që lidhen me analizat e qëndrueshmërisë financiare, të diagnostikimit dhe përcaktimit të rrugëve për uljen e humbjeve dhe Ujit Pa të Ardhura, si dhe të përmirësimit të punës për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, përkatësisht:

“Studimi për Familjet me Ndhimë Ekonomike dhe Influenca në Qëndrueshmërinë Financiare të Shoqërive UK” është realizuar dhe prezantuar nga ERRU dhe në Konferencën Ballkanike Vjetore për Ujin të zhvilluar në nëntor në Tiranë organizuar nga SHUKALB dhe SHUKOS.

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i influencës së arkëtimeve nga Familjet në Nevojë në qëndrueshmërinë financiare të Shoqërive UK, dhe alternativat e kompensimit për këtë kategori konsumatorësh dhe/ose për Shoqëritë UK në garantim të qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Nga studimi rezultoi se familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike në rang kombëtar përbëjnë rreth 10% e numrit total të popullsisë. Kjo përbindje e lartë është shqetësuese sepse kjo shtresë e ka të pamundur të paguajë faturën e shërbimeve të UK dhe zë një peshë të konsiderueshme në të ardhurat që duhet të arkëtojnë shoqëritë UK për qëndrueshmërinë financiare të tyre. Në këtë kuadër është e nevojshme që të gjendet një zgjidhje në formën e një mekanizmi kompensimi të shoqërive UK për pamundësinë e arkëtimit direkt të faturimit nga kjo shtresë e popullsisë. Studimi përcakton dhe se ku duhet të orientohen subvencionet nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.

“Raporti i Bilancit të Ujit për Sektorin UK” është hartuar për sektorin në përgjithësi dhe për çdo shoqëri UK në veçanti. Raporti jep të dhëna dhe orientime të cilat shërbejnë për të nxjerrë konkluzione të rëndësishme dhe rekomandime në drejtim të planeve të veprimit që shoqëritë UK duhet të ndjekin për reduktimin e Ujit Pa të Ardhura, përkatësisht për përbërësit kryesorë të humbjeve administrative dhe atyre fizike.

“Modeli i Monitorimit për Ankesat e Konsumatorëve” ndaj shoqërisë UK Tiranë, si model praktike dhe e unifikuar monitorimi për të gjitha shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t’u ankuar nëpërmjet një procedure korrekte ligjore, dhe që trajtimi i këtyre ankesave të gjejë një zgjidhje praktike dhe sa më të drejtë nga ana e shoqërive UK.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit të veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullatore vjetore të përcaktuara në kontratat me shoqëritë UK si dhe pagesat për licencime.

Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2020, sipas kontratave që ERRU ka me shoqëritë UK, ka qenë 51.689.786 lekë, ndërsa të ardhurat vjetore të realizuara nga veprimtaria gjatë vitit kanë qenë 54.440.928 lekë. Realizimi rezultoi pak mbi vlerën e planifikuar për shkak të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura.

Shpenzimet buxhetore për ushtrimin e aktivitetit për vitin 2020 kanë qenë 49.287,733 lekë, ndërsa janë realizuar 38.727.133 Lekë, ose 79 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Arsytet e mosrealizimit të plotë të shpenzimeve të parashikuara janë të lidhura me mbylljen dhe kufizimin nga pandemia Covid-19 që ka reduktuar shpenzimet në zërat Shërbime dhe Furniturë, si edhe prania përgjatë gjysmës së parë të vitit 2020 e tre vendeve vakante në organogramë që reduktuan zërin e Fondit të Pagave dhe Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Në mbyllje të vitit 2020, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të ERRU garanton plotësisht mbulimin e planit të shpenzimeve të vitit 2021.

Performanca e Sektorit UK dhe Analiza e çdo Treguesi të Veçantë

ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e sektorit UK në tërësi dhe secilit operator në veçanti për shërbimet e furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2020 dhe tendencën e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2019 jepen në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2019	Viti 2020	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	63.7	65.1	↘
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	107.1	103	↘
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	79.8	76.8	↘
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	95.8	89.9	↘
5	Niveli i Matjes	%	77.3	79.4	↗
6	Efiçenca e Stafit	(stafi/1000 lidhje UK)	5.33	5.23	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	13.3	13.79	↗
8	Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	76.8	75.8	↘
9	Mbulimi me Kanalizime	%	51	50.8	=

Burimi: ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2020 tregojnë se gjendja në sektor në krahasim me vitin 2019 paraqet një përkeqësim në drejtim të treguesve të Ujit Pa të Ardhura, Mbulimit të Kostove Direkte të O&M, Normës së Arkëtimit si dhe treguesit Mbulimi me FU. Treguesi Mbulimi me kanalizime ka mbetur në të njëjtin nivel ndërkohë që ka përmirësim në treguesit e tjerë si Nivelin e Matjes, Kohëzgjatja e FU, si dhe Efienca e Staf/1000 lidhje UK.

Përgjithësisht përkeqësimi i gjendjes së sektorit shpjegohet me pasojat nga pandemia COVID 19, si dhe vazhdimësinë e atyre të tërmetit të fuqishëm të ndodhur në fundit të vitit 2019.

Në përgjithësi, treguesit kryesorë të performancës kanë ndërruar nga njëri-tjetri dhe ndikimi pozitiv apo negativ i secilit tregues reflektohet dhe në treguesit e tjerë, gjë që ka sjellë përkeqësimin në grup të pothuaj të të gjithë treguesve të performancës. Më poshtë jepet me detaje analiza e ecurisë për secilin tregues kryesor të performancës.

"Uji Pa të Ardhura" (UPA), si një nga treguesit më të rëndësishëm në vitin 2020 është përkeqësuar pas një periudhe disa vjeçare stanjacioni, përkatësisht nga 65.1% në 63.7 % që ishte në vitin 2019. Ndikimin negativ në këtë tregues e ka dhënë rritja e konsiderueshme e ujit të prodhuar me 12.2 milion m³ ujë në një kohë që uji i faturuar ka mbetur pothuaj në të njëjtin nivel. Rritja kryesore ka ardhur nga UK Durrës me 9,6 milion m³ si rezultat i vënies në shfrytëzim të burimit të ri në Fushë Milot shtesë ndaj atyre ekzistuese nga burimet e Fushë Kuqes si rezultat i investimit nga Banka Botërore të një sistemi të ri ujësjellësi me prurje shtesë prej rreth 630 litra/sek.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" shpreh mbulimin e kostove direkte me të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë (përfshijtur subvencionet). Në këto kosto përfshihen ato për personelin, energjinë, kimikatet dhe kosto të tjera sekondare që lidhen me O&M. Ky tregues për vitin 2020 është në vlerën e 103% nga 107.1% që ishte në vitin 2019. Kjo si rezultat i përkeqësimit të situatës financiare në mjaft shoqëri dhe në rang sektori, ku nga totali prej 57 shoqëri vetëm 9 prej tyre arrijnë të mbulojnë mbi 100% kostot O&M nga 14 shoqëri që ishin në vitin 2019. Në 48 shoqëritë me performancë të dobët, 23 shoqëri performojnë nën nivelin 70% të këtij treguesi që me vështirësi mbulojnë pagat e personelit. Pjesa tjetër prej 25 shoqërive që mbeten janë në nivelet 71% deri 100% të këtij treguesi. Vetëm dy shoqëri në sektor, përkatësisht UK Tiranë dhe UK Ersekë, arrijnë të mbulojnë edhe kostot totale, në të cilat përfshihen dhe kostot e amortizimit dhe të interesave të kredive.

"Norma e Arkëtimit" është një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës së shoqërive, që lidhet me qëndrueshmërinë financiare dhe me aftësinë paguese të tyre. Norma e Arkëtimit Korrente për të gjithë sektorin është përkeqësuar për vitin 2020 në 76.8 % nga 79.8% që ishte në vitin 2019. Ndikim negativ në rënie të nivelit të arkëtimit ka dhënë edhe situata e krijuar nga Pandemia Covid-19 që presupozohet që ka rritur numrin e familjeve të kategorisë me ndihmë ekonomike, që normalisht nuk mund të paguajnë faturën e shërbimeve të FU dhe KUN. Gjithashtu faktor tjetër negativ në mbledhjen e të ardhurave vlerësohet të jetë edhe nga pasojat e tërmetit të cilat shkatërruan plotësisht mjaft banesa dhe pallate të cilat nuk faturohen akoma gjatë kësaj periudhe.

"Niveli i Matjes" është përmirësuar me 2.1%, krahasuar me vitin 2019 dhe ka arritur nivelin rreth 80% për të gjithë sektorin. Gjatë vitit janë instaluar rreth 35 mijë matës uji. Në sektor ende raportohen 186,717 klientë pa matës nga të cilët 7,448 janë të kategorisë jo familjarë. Gjithsesi duhet të forcohet vëmendja për pajisjen e 100% të konsumatorëve me matës, jo vetëm për faktin se çdo konsumator duhet të paguajë volumin real të ujit të konsumuar, por faturimi aforfe lë shteg për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale. Kjo jep një impakt negativ edhe në treguesin tjetër të Uji Pa të Ardhura.

"Eficienca e Stafit" është 5.23 punonjës për 1000 lidhje UK kundrejt 5.33 që ishte në vitin 2019. Ky tregues luhet në varësi të dy variabëlve që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK. Gjatë vitit 2020 numri i lidhjeve të ujit është rritur me rreth 21,256 lidhje dhe ai i kanalizimeve me rreth 22,869 lidhje, dhe nga ana tjetër numri i stafit është rritur me 42 punonjës. Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje, veçorive të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN, por është evident dhe abuzimi me punësimet e pajustificuara. Gjithsesi është e nevojshme që të thellohet analiza për vlerësimin real të këtij treguesi bazuar në organogramën përkatëse të shoqërisë dhe justifikimin e çdo pozicioni të punës në përputhje me përshkrimin e saj.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" lidhet direkt me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë që furnizohen konsumatorët. Ky tregues për vitin 2020 ka një tendencë të lehtë përmirësimi me 0.49 orë në ditë, si rezultat i investimeve me fonde të qeverisë qendrore nëpërmjet AKUM-it. Në sektor operojnë 8 shoqëri UK që kanë furnizim të pandërprerë dhe me cilësi të lartë 24/7 ditë. Pjesa dominuese e shoqërive ofrojnë në nivele relativisht të mira 10-15 orë në ditë.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" si tregues është përqësuar nga 76,8% që ishte në vitin 2019 në 75.8% në vitin 2020. Kjo ka ardhur si rezultat i vazhimit të procesit të riorganizimit të sektorit. Në disa bashki popullsia në zonën e juridiksionit rezulton të jetë rritur me 85 mijë banorë ndërsa ajo e shërbyer me rreth 40 mijë. Zgjerimi i zonës së shërbimit të shoqërive me zonat e bardha ose të pa shërbyera më parë influencon në përqësimin "artificial" të treguesve të performancës për shoqërinë, zona të cilat kërkojnë investime të konsiderueshme fizike.

"Mbulimi me Kanalizime" është pothuajse konstant me atë të vitit 2019. Popullsia me shërbimin e KUN është rritur me rreth 35 mijë banorë si rezultat i futjes në skemën e këtij shërbimi të klientëve, si në shoqëritë UK Patos dhe UK Peqin, ku më parë ky shërbim ofrohej direkt nga bashkitë përkatëse. Gjithsesi krahas 2.2 milion banorëve që shërbehen nga shoqëria akoma rreth 216 mijë prej tyre e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike.

**Objektivat e
ERRU-së për
Vitin 2021**

- ❖ Në rast të mos aprovimit të projekt-ligjit të ri për sektorin UK të ndjekë procedurat për rishikimin e Ligjit Nr. 8102 për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të sektorit.
- ❖ Përfundimin e punës për rishikimin dhe hartimin e "Metodologjisë së vendosjes së tarifave për shërbimin e UK", për përfundimin e së cilës u bë pengesë pandemia e COVID 19.
- ❖ Të synohet me mbështetjen e donatorëve hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK, përfshirë dhe trajnimet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që të fillojë realizimi i 2-3 shembujve pilot agregimi të suksesshëm të shumë shoqërive UK në sektor, si një nga drejtimet kryesore të strategjisë për përmirësimin e performancës në sektor mjaft të fragmentarizuar me 57 shoqëri UK.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues për rishikimin e nën akteve ligjore që lidhen me Akt Miratimin Higjieno Sanitar që duhet të përfitojnë Shoqëritë UK për t'u pajisur me Licencë nga ERRU.
- ❖ ERRU të vazhdojë përpjekjet për forcimin e rolit të ERRU deri në pozita institucionale vendimmarrje për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërive UK që shpesh mbajnë qëndrim arbitrar.
- ❖ Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit me një planifikim të drejtë të trajnimit të tyre me burime të brendshme dhe të jashtme duke shfrytëzuar edhe mundësitë nga bashkëpunimet e gjëra dhe bilaterale me rregullatorët Evropianë të sektorit të ujit.
- ❖ Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.
- ❖ Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorëve të tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK.

**Rekomandime
për
Përmirësimin e
Performancës
së Sektorit UK
dhe të ERRU-së**

- Hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK nga ERRU, si dokumenti bazë në mbështetje të justifikimit të tarifave të propozuara nga Shoqëritë UK, dhe si instrument i domosdoshëm për përmirësimin e menaxhimit të shoqërive në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tyre.
- Hartimi i akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjieno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjieno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i nënakteve të mësipërme do të shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e riskut të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, si një domosdoshmëri për zgjidhjen e problemit të licencimit të shoqërive UK.

- Është tashmë e njohur ideja dhe domosdoshmëria e procesit të agregimit të Shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit, dhe nisja e procesit bazuar në principin “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme, ku ERRU duhet të para vlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Si një element kyç për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive UK, të thellohet procesi i hartimit të Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive bazuar në Tregues Kryesore të Performancës aktuale dhe ato si objektiva të vlerësuar realisht, proces në monitorimin e të cilave duhet të përfshihet edhe ERRU. Realizimet e vlerësuara të këtyre kontratave të shërbejë si kriter bazë edhe për shpërndarjen e subvencioneve nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.

1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është institucion i pavarur publik, i cili e bazon veprimtarinë e tij në aktet ligjore dhe nënligjore, me referencë kryesore ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (shih Aneks 6 referenca Ligjore)

ERRU është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar. Qëllimi kryesor i ligjit nr. 8102 është mbrojtja e interesave publike dhe krijimi i një mjedisi transparent dhe ligjor në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nxitje dhe forcimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive ujësjellës kanalizimeve.

Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 581, datë 18.07.2018, ERRU është pjesë e grupit ndërinstytucional të punës të ngritur për hartimin e ligjit të ri për sektorin ujësjellës kanalizime. ERRU ka përcjellë propozimet dhe komentet mbi draftin e hartuar, ku rëndësi e veçantë i është vënë forcimit të pavarësisë institucionale të rregullatorit.

ERRU beson se forcimi i rolit të rregullatorit duhet të ishte realizuar duke amenduar ligjin nr. 8102, ndërkohë që ndryshimet sa i takon kompetencave të institucionit u përfshinë në draftin e ligjit për sektorin e ujit, draft i cili akoma nuk ka përfunduar procesin e shqyrtimit nga Këshilli i Ministrave dhe më tej nga Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Ende nuk ka informacion në lidhje me vazhdimësinë e këtij procesi në të cilin varen dhe ndryshimet ligjore të domosdoshme për institucionin e ERRU-së.

Lidhur me akte të tjera ndihmëse ligjore ku ERRU duhet të ushtrojë përgjegjësitë e veta ligjore përmendim:

Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë me kosto më të ulët, reduktimit të procedurave, si dhe sigurimit të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.

Në rastet kur do të lindin mosmarrëveshje mbi refuzimin e aksesit apo termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë edhe çmimin, ERRU do të jetë autoriteti përgjegjës për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, kur aksesit është kërkuar nga një sipërmarrës i komunikimit elektronik te një operator rrjeti që vepron në sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Ligji nr.71/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e Konsumatorëve", parashikon krijimin e një strukture përgjegjëse pranë ERRU-së për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) midis shoqërive UK dhe konsumatorëve në lidhje me shërbimin UK ofruar këtyre të fundit duke sjell një risi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve/ankesave nëpërmjet kësaj strukture.

Në zbatim të këtij ligji, gjatë vitit 2020 është miratuar VKM-ja e cila pritet të publikohet në Fletore Zyrtare e cila parashikon krijimin dhe mënyrën e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme për zgjidhjen e alternative të mosmarrëveshjeve, strukturë pranë ministrisë përgjegjëse dhe gjithashtu përcaktimin e kriterëve shtesë që duhet të përmbushin strukturat pranë autoriteteve rregullatore si ERRU dhe mënyra e funksionimit të tyre. ERRU ka dhënë komente dhe rekomandime të detajuara në lidhje me VKM-në e mësipërme për një përmirësim të procedurave dhe efikasitet të zgjidhjes së problematikave dhe ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërive UK, proces në të cilin ERRU është thellësisht i përfshirë.

1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”

ERRU nuk është subjekt i detyrimeve ndërkombëtare, si dhe i rekomandimeve të “Progres-Raportit për Shqipërinë” që duhen përmbushur prej saj.

1.3 Struktura Organizative e ERRU-së

Struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit, miratohen me vendim të Kuvendit të Shqipërisë.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)". Në përbërje të Entit Rregullator të Ujit është Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Struktura organizative e ERRU-së, jepet në figurën 1.




Figura 1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

Kjo strukturë, ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU-ja ka përballë reformës së sektorit ujësjellës kanalizime që burojnë edhe nga objektivat strategjike të institucionit.

ERRU, në vazhdimësi, do të propozojë ndryshime të strukturës organizative në funksion të përmirësimit të performancës së saj, si aktor kryesor në sektorin e ujit, dhe në përgjigje të kërkesave të reja që parashtron vazhdimësia e reformës në sektorin e ujit dhe rritja e performancës së saj në përgjithësi.

1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me procesin e licencimit (shih Aneks 6 Referencat Ligjore), Enti Rregullator i Ujit përgjatë vitit 2020 ka marrë në shqyrtim kërkesën për licencim, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, teknik si dhe përfundim të afatit të licencës së mëparshme për 21 shoqëri UK. ***Si përfundim gjendja aktuale e licencimit të shoqërive është nga totali prej 57 shoqëri UK 49 prej tyre rezultojnë të licencuara në përputhje me ligjin nga ERRU.***

Në mbyllje të vitit 2020, shërbimi i "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik" kryhet nga 57 shoqëri UK, nga të cilat vetëm 2 prej tyre kryejnë edhe shërbimin e "përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik". Shërbimi i "grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura" ofrohet nga 52 shoqëri UK ndërsa përpunimi i tyre arrihet të kryhet vetëm nëpërmjet 8 impianteve të ndërtuara ndër të cilat vetëm katër prej tyre janë të pajisur me licence nga ERRU ndërsa katër shoqëritë e tjera ende nuk plotësojnë kërkesat ligjore për licencim për këtë kategori shërbimi.

Aplikimet për licencim gjatë vitit 2020 kanë qenë si pasojë e:

- a) përfundimi i afatit të licencës për 9 (nëntë) shoqëri UK
- b) ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik në 10 (dhjetë) shoqëri UK
- c) aplikim për ndryshim të zonës së shërbimit për 2 (dy) shoqëri, UK Fier dhe UK Patos

Nga aplikimet e këtij viti, KKRR ka marrë 19 vendime në favor të 17 shoqërive UK dhe ka miratuar 18 prej tyre. Aplikimi i UK Rrogozhinë mbi ndryshimin e drejtuesit teknik u refuzua pasi nuk plotësonte kërkesat ligjore të përcaktuara në VKM nr.958 dhe Rregulloren e Licencimit. lidhur me këtë pozicion shoqëria UK Vorë ka aplikuar 3 herë brenda vitit.

Pajisja me akt miratimin higjieno – sanitar si dhe bashkimi me shoqërinë UK Krastë bëri të mundur dhe licencimin e sha UK Bulqizë, e cila operonte pa licencë.

Theksohet fakti se mbetet akoma shqetësim për rregullatorin zbatim i VKM nr. 63, datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK”, ku përfshihet edhe procesi i licencimit të shoqërive UK të riorganizuar. Në këtë rast hapat për licencim duhet të ndiqen sipas procedurës, përkatësisht vlerësim dhe përfundim i inventarizimit të aseteve të shoqërisë së riorganizuar, të reflektuara këto në QKB dhe më pas paraqitja në ERRU për licencim. Më tej, dhe jo më vonë se tre muaj shoqëria e riorganizuar dhe licencuar duhet të aplikojë për miratimin e tarifave të reja.

Si përfundim, gjatë vitit 2020 KKRR ka miratuar licencimin për (19) shoqëri UK (UK Vorë 3 herë), ndërsa dy (2) aplikime mbetën në proces (**shih Aneksi 1 Tabela 1**).

Arsyet e “aplikimeve në proces” si dhe “shoqëritë pa licencë” janë mos plotësimi i kërkesave në zbatim të VKM nr. 958, për licencimin e operatorëve nga ERRU në fushën e ujësjellës kanalizimeve, dhe kryesisht për:


- **Pamundësia e Marrjes së Akt-miratimit Higjieno-Sanitar** nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo ka ardhur kryesisht sepse shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit me zona shtesë rurale që kanë asete mjaft të amortizuara të sistemeve të furnizimit me ujë. E njëjta problematikë është evidentuar edhe tek shoqëritë e reja të krijuara rishtas në sektor, përkatësisht Pustec, Kamëz dhe Klos;
- **Emërimin e drejtuesve teknik** të kualifikuar në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në VKM Nr.958.

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2020 për shoqëritë UK paraqitet si më poshtë, si dhe grafiku në Figurën 2:

- Dyzet e nëntë (49) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- Dy (2) operatorë UK Tiranë dhe UK Selenicë janë në proces për rinovim të licencës pranë ERRU-së. ERRU ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur për licencim nga UK Tiranë, për të cilin akt miratimi higjieno – sanitar nuk mbulon të gjithë zonën e shërbimit duke lënë jashtë një pjesë të zonës rurale, përkatësisht njësitë administrative Baldushk, Pezë, Farkë dhe Bërzhitë. UK Tiranë që në fillim të vitit ka bërë kërkesën pranë DRSHP edhe për këto zona, por situata e COVID 19 e ka bërë të pamundur angazhimin në terren të specialistëve të DRSHP për të

vlerësuar gjendjen dhe lëshimin e Akt Miratimit Higjiene Sanitar për këto zona. Në këtë situatë ERRU po shqyrton mundësinë për dhënien e licencës për UK Tiranë të kushtëzuar në kohë dhe vetëm për zonën e mbuluar nga Akt-Miratimi Higjiene Sanitar lëshuar më parë nga DRSHP Tiranë. UK Selenicë e cila megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për licencim, aplikimi nuk u arrit të kalohej për vendimmarrje në KKRR këtë vit, pasi aplikimi nga ana e shoqërisë u dorëzua në ditët e fundit të vitit.

- Tre (3) operatorë (U Divjakë, UK Has dhe UK Lushnje) operojnë me licencë të pavlefshme:
 - **U Divjakë** ende nuk ka kryer reflektimet përkatëse pranë QKB. ERRU ka organizuar disa takime me shoqërinë ku i është kërkuar të licencohet vetëm për zonat ekzistuese të saj deri sa të përfundojë riorganizimi i plotë i shoqërisë. Në inspektimin e fundit të kryer pranë shoqërisë, ndonëse KKRR doli me vendimin “masë administrative me gjobë” shoqëria ende nuk ka reaguar për finalizimin e procesit të licencimit.
 - **UK Has** i ka mbaruar afati i licencës në korrik 2020, por akoma nuk ka aplikuar për rinovim licence edhe pas njoftimeve të vazhdueshme nga ERRU. Në rast mos reagimi të mëtijshëm nga shoqëria për tu rilicencuar, ERRU do të zbatojë masat penalizuese të parashikuara në legjislacion për këto raste.
 - **UK Lushnje** i ka mbaruar afati i licencës në shtator të këtij viti por ende nuk ka aplikuar për rinovim licence edhe pas njoftimeve të vazhdueshme nga ERRU. Gjithashtu edhe për këtë rast nëse nuk ka reagim të shpejtë nga shoqëria për tu rilicencuar, ERRU do të zbatojë masat penalizuese të parashikuara në legjislacion për këto raste.
- Tre (3) operatorë të rinj (UK Kamëz, UK Klos dhe UK Pustec), me gjithë komunikimet e vazhdueshme, ende nuk janë pajisur me licencë, pasi nuk arrijnë të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar për licencim, kryesisht për problematikën e marrjes së Akt-Miratimit Higjiene Sanitar, të inventarit të aseteve etj. Gjithsesi nëse nuk ka reagim të shpejtë nga shoqëritë e mësipërme për tu rilicencuar, ERRU do të zbatojë masat penalizuese të parashikuara në legjislacion për këto raste.



Grafiku 1. Situata aktuale e licencimit

Në grafikun 1, jepet situata e licencimit në përqindje, ndërsa për secilën nga 57 shoqëritë UK jepet në Aneks 1, Tabela 2.

ERRU vazhdimisht ka bërë përpjekje për të aktivizuar institucionet që janë përgjegjëse dhe kanë autoritetin për rishikimin e akteve dhe nënakteve ligjore përkatëse për përfundimin e Akt Miratimit Higjieno Sanitar shoqëritë UK nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Ky problem u ngrit përsëri në raportimin e ERRU-se në vitin 2020 pranë Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Më tej, sipas kërkesës së tij u informua në veçanti z. Ilir Beqaj, Deputet i këtij Komisioni për të gjithë përpjekjet e ERRU (korrespondenca) dhe progresin e procesit pranë institucioneve përkatëse.

1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor

Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.06.1998, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ERRU është autoriteti i vetëm që miraton tarifat e shërbimeve UK, si dhe përcakton metodologjinë e përlogaritjes së tarifave.

Procesi i miratimit të tarifave për shërbimet UK, bazuar në kompetencat që i jep ligji Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) rregullohet sipas akteve nën-ligjore të miratuara nga ky i fundit.

Në këtë kuadër, KKRR ka miratuar aktet normative për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet e licencuara, ka si baze Vendimin nr. 42, datë 09.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura". Nënaktet e plota të miratuara nga KKRR për procesin tarifor jepen në Aneksin Nr. 6 Referenca Ligjore.

Objektivi kryesor i ERRU-së në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit.

Disa shoqëri UK që operojnë në zonat që u prekën rëndë nga tërmeti i fundvitit 2019, gjatë vitit 2020 hasën probleme, të cilat u theksuan më tepër nga problemet e krijuara nga pandemia Covid-19. Problemet kanë qenë kryesisht të performancës financiare që lidhen me pasojat negative ekonomike të eventeve tragjike të mësipërme, kryesisht nga shtimi e papunësisë dhe falimentimi i bizneseve që ulin aftësinë paguese të konsumatorëve familjarë dhe atyre të bizneseve private.

Duhen patur parasysh gjithashtu edhe vështirësitë e tjera shtesë që kanë hasur shoqëritë UK në lidhje me kostot shtesë të imponuara nga pandemia. Pandemia ka krijuar gjithashtu pamundësi në mjaft raste për të përgatitur dokumentacionin ligjor për të aplikuar për nivel të ri tarifor pranë ERRU. Përmendim këtu vështirësitë dhe pamundësitë për të realizuar seancat dëgjimore me publikun, shtyrjen nga qeveria të afatit me 4 muaj (deri në fund të muajit korrik në vend të fundit të muajit mars) të detyrimit të paraqitjes së balanceve financiare të certifikuara të aktiviteteve të shoqërisë që shërbejnë bazë referimi të dhënash për tarifat e propozuara, si dhe të realizimit të kërkesave të tjera në zbatim të ndryshimeve që kanë pësuar shoqëritë nga zbatimi i Reformës Territoriale.

Me gjithë vështirësitë e krijuara nga situata e pandemisë, ERRU ka inkurajuar dhe mbështetur shoqëritë që të aplikojnë për një nivel të ri tarifor për përmirësimin e performancës financiare të tyre.

Konkretisht gjatë vitit 2020 kanë aplikuar për nivel të ri tarifor 5 shoqëri ku për tre prej tyre është mbyllur procedura deri në vendimarrje brenda vitit 2020 përkatësisht për UK Pogradec, UK Peqin dhe UK Fier sipas vendimarrjeve përkatëse të KKRR që jepen në Tabelën 1.

UK Patos është në fazën përfundimtare ku analiza e tretë ka kaluar në KKRR dhe vendimarrja përfundimtare do të jetë në fillim të janarit 2021, ndërsa për shoqërinë UK Sarandë është marrë vendimi nga KKRR për fillimin e procedurës për tarifat e reja pasi i gjithë dokumentacioni i aplikimit që ka paraqitur shoqëria rezultoi i rregullt.

Tabela 1. Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendimet për ndryshimin e tarifave

Nr.	Operatori	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit
1	UK Pogradec	99	25.08.2020
2	UK Peqin	119	20.10.2020
3	UK Fier	142	27.11.2020

Motivi kryesor i aplikimeve për tarifa të reja nga shoqëritë e mësipërme ka qenë:

- Përmbushja e detyrimit ligjor për shoqëritë UK për të aplikuar për tarifa të reja sipas pikës 3, kreu II, VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", nga nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit të tyre, duke qenë se tarifat që aplikohen janë të niveleve të ndryshme në zonën e tyre të shërbimit.
- Aplikimi për tarifa të reja si rrjedhojë e nevojës për rritje të qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, në përputhje me nenin 22, Ligji nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", drejt mbulimit 100% të kostove të operim-mirëmbajtjes.

Detaje të aplikimeve të mësipërme jepen më poshtë:

UK Pogradec ka aplikuar në Prill 2020, ku u kalua nga tarifa volumetrike për shërbimet UK me dy blloqe konsumi, në sistemin tarifor me një nivel ose bllok tarifë volumetrike për secilin shërbim për të mbuluar mbi 100% të kostove të operim mirëmbajtjes dhe mbulimit të një pjese të mirë të kostove totale. Aplikimi i sistemit të tarifave volumetrike me dy blloqe rezultoi i papërshtatshëm për këtë qytet të orientuar kryesisht nga turizmi, sistem i cili favorizonte me pa të drejtë të gjithë konsumatorët e përhershëm rezidentë për periudhën rreth 10 mujore të vitit nga gushti në qershor duke krijuar një situatë financiare të pafavorshme dhe problematike për shoqërinë.

UK Peqin ka aplikuar në Korrik 2019, (dokumentacioni është saktësuar dhe plotësuar konform Metodologjisë së Vendosijs së Tarifave gjatë vitit 2020), ku synimi kryesor ishte rritja dhe unifikimi i tarifave për të gjithë zonën e shërbimit për të dy shërbimet atë të FU dhe shërbimin e KUN. Tarifat e reja synojnë rritjen e performancës financiare të shoqërisë duke ju afruar treguesit të mbulimit të plotë prej 100% të kostove të operim mirëmbajtjes.

UK Fier ka aplikuar në Shkurt 2020 me qëllim unifikimin e tarifave në përputhje me kërkesat e ristrukturimit të shoqërisë nga reforma për zonat e reja që janë shtuar në juridiksionin e shoqërisë me atë të zonës ekzistuese, tarifa që do të sjellin gjithashtu një përmirësim të mëtejshëm të situatës financiare të shoqërisë UK Fier.

UK Patos ka aplikuar në Tetor 2020. Shoqëria UK Patos aplikon për herë të parë për tarifa të reja pranë ERRU-së. Kjo është një nga shoqëritë me performancë mjaft të dobët financiare, si rezultat i kostove mjaft të larta, veçanërisht ato të energjisë elektrike. Tarifat e reja të propozuara synojnë rritjen e performancës financiare të shoqërisë edhe në kuadër të riorganizimit të saj për të mbuluar të gjithë territorin administrativ të bashkisë Patos. Shoqëria aplikon gjithashtu për herë të parë për konsumatorët tarifa shërbimi për kanalizimet e ujërave të ndotura, shërbime që më parë ofroheshin dhe financoheshin direkt nga bashkia Patos. Aktualisht është hartuar dhe shqyrtuar nga KKRR analiza përfundimtare e propozimit të shoqërisë për tarifa të reja. Vendimi përfundimtar pritet të merret në mbledhjen e parë të KKRR në Janar 2021.

ERRU, si autoriteti ligjor që miraton tarifën e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve në përputhje me Metodologjinë përkatëse, kryen një analizë të detajuar financiare duke marrë në konsideratë vetëm kostot e arsyeshme dhe të justifikuara me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit. Nga ana tjetër ERRU bën vlerësimin e performancës aktuale dhe të pritshme të këtyre shoqërive, duke përcaktuar dhe objektiva për të ardhmen. Monitorimi i tarifave të miratuara është pjesë e vijimit të punës nga ERRU.

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja, ERRU ka patur një bashkëpunim të ngushtë me stafet e Shoqërive UK për saktësimin e të gjithë dhënave dhe elementëve të nevojshëm tekniko-ekonomikë, që ndikojnë për një analizë sa më të plotë dhe konstruktive të tyre.

Para marrjes së vendimit përfundimtar për tarifën e propozuar nga shoqëritë, ERRU i dërgon Shoqërisë, Bashkisë përkatëse, si dhe Autoritetit të Konkurrencës për komente Projekt-Vendimet përkatëse të shoqëruara me një raport analizash mjaft të detajuara. Është fakt që deri tani të gjitha Projekt-Vendimet para se të marrin formën e vendimit përfundimtar nga ERRU, janë konfirmuar nga Shoqëritë dhe bashkitë përkatëse, si edhe nga Autoriteti i Konkurrencës.

Kriteri i rëndësishëm që ERRU konsideron gjatë analizës dhe vendim marrjes për tarifa të reja është ai i Përbalueshmërisë së Pagesës së Faturës së Shërbimeve nga Konsumatorët Familjarë. Në të gjitha rastet e miratimit të tarifave ERRU ka përmbushur kriterin që fatura mujore të mos kalojë nivelin prej 5% të shpenzimeve mujore që INSTAT publikon në dokumentin "Anketa e Buxhetit të familjes për vitin respektiv" për të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.

Gjithsesi trajtimi i problemit të përbalueshmërisë është bazuar në informacionin që INSTAT nuk përfshin të ardhurat e kategorisë së shtresave në nevojë të popullsisë. Gjithsesi kjo shtresë që zë aktualisht rreth 10% të popullsisë së vendit nuk ka mundësi financiare që të paguajë faturën e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve. Impakti në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK është i konsiderueshëm gjë që reflektohet shpesh në normat e ulëta të arkëtimit të faturave që realizojnë shoqëritë UK.

Paraqitet imediate nevoja e ndërtimit dhe aplikimit të politikave sociale realiste dhe praktike për këto shtresa të popullsisë, të cilat duhet të marrin parasysh edhe kompensimet përkatëse ndaj shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve që shoqëritë UK i ofrojnë kësaj shtrese të popullsisë.

Gjithsesi konstatohet se tendenca e ndryshimit të tarifave për shërbimet FU dhe ITUN ka ardhur në rritje, por ende fatura mujore për familje me konsum mesatar 12 m³ në muaj për të gjithë sektorin UK përmban rezerva jo të vogla në drejtim të përballueshmërisë së pagesës së saj nga konsumatorët familjarë.

Me gjithë ndikimin e ERRU në rregullimin e sektorit UK, rezulton se shumë shoqëri UK gjatë vitit 2020 gjenden në vështirësi reale financiare. Përmenden këtu në total 48 shoqëri UK nuk arrijnë të mbulojnë kostot e operim mirëmbajtjes nga totali prej 57 shoqëri UK. Kryesisht, veçohen shoqëritë e vogla, ato të Grupit III, ku nevoja për të ardhura për të përballuar kostot kërkon tarifa të larta, shpesh bien ndesh me përmbushjen e kriterit të përballueshmërisë së pagesës së faturës së shërbimeve nga konsumatorët familjarë. Këto shoqëri duhet të vazhdojnë të mbështeten me subvencione nga Qeveria Qendrore deri në një zgjidhje të situatës financiare të tyre me anë të procesit të agregimit.

Në procesin e aplikimeve dhe të analizës për propozimet për tarifa të reja gjithsesi mbetet akoma problem pasaktësia e informacionit si dhe ndonjë mangësi në dokumentacion. Kjo ka detyruar në disa raste stafin e ERRU-së që të asistojë nga afër shoqëritë me qëllim përgatitjen e një aplikimi dhe propozimi për tarifa të reja në mënyrë konstruktive dhe të argumentuar. Kjo ka qenë veçanërisht e evidente për shoqëritë e vogla dhe ato të krijuara rishtas që paraqiten me mangësi në drejtim të kapaciteteve njerëzore. Në këto raste, procesi i analizës zgjatet në kohë, derisa të plotësohet dokumentacioni në përputhje me standardet e përcaktuara në Metodologjinë e Vendosijes së Tarifave.

Saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave vazhdon të mbetet një shqetësim dhe nga ana tjetër prioritet i punës së ERRU-së, reflektuar kjo në analizën teknike ekonomike të aplikimeve për miratim tarifash për shërbimet UK.

1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2020 Enti Rregullator i Ujit ishte pjesë në 7 (shtatë) procese gjyqësore nga të cilat 6 (gjashtë) procese gjyqësore të iniciuara nga vetë ERRU me objekt shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pagesës rregullatore nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime. Procesi gjyqësor i shtatë është në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku ERRU është paditur me objekt Zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës, proces i cili është fituar në shkallë të parë nga ERRU.

Pas përpjekjeve të vazhdueshme të Entit për nxitjen e shoqërive për shlyerjen e pagesave rregullatore, detyrimet e akumuluar në vite detyruan ERRU ti drejtohej gjykatës për zgjidhjen e problematikës së krijuar.

Aktualisht çështjet gjyqësore janë në fazat si më poshtë:

1. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Peqin sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Peqin sh.a.

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Peqin” sh.a. të paguajë shumën 960,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktuar.

Kjo çështje është aktualisht në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore të dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

2. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Selenicë sh.a.

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Selenicë sh.a.

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Selenicë” sh.a. të paguajë shumën 351,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktuar.

Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka dhënë vendim përfundimtarë duke vendosur detyrimin e Ujësjiellës Selenicë” sh.a. të paguajë në favor të Entit Rregullator të Ujit shumën prej 351,000 lekë. Kjo çështje nuk është ankimuar nga shoqëria UK Selenicë.

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Skrapar sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Skrapar sh.a

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Skrapar” sh.a. të shlyejë shumën prej 266 917 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktuar.

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” sh.a. të shlyejë shumën 4,854,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i papërbushur kontraktuar.

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Devoll sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Devoll sh.a

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Devoll” sh.a. të shlyejë shumën 233 100 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i papërbushur kontraktual.

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykata e Rrethit Gjyqësor.

6. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjiellës Kanalizime Pukë sh.a

Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit

Palë e paditur: Ujësjiellës Kanalizime Pukë sh.a

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Pukë” sh.a. të shlyejë shumën 425,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i papërbushur kontraktual.

Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Luena Brekofca - Enti Rregullator i Ujit

Palë Paditëse: Luena Brekofca,

Palë e Paditur: Enti Rregullator i Ujit

Objekti:

1. Shfuqizim i vendimit nr.15, datë 25.03.2019 “Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës”;
2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi page;
4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;

5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditëshi për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysëm shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;

Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesë – padisë. Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë e cila nuk e ka shqyrtuar deri në këtë moment çështjen e sipërcituar.

1.4.4 Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve

Edhe për vitin 2020, trajtimi i ankesave të konsumatorëve ka qenë në fokusin e punës së rregullatorit jo vetëm që marrëdhënia kontraktuale Shoqëri UK - Konsumator të jetë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, por edhe të garantojë cilësinë dhe vazhdueshmërinë e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

Për shkak të pandemisë viti 2020 ka qenë i vështirë për të mundësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e duhur me konsumatorët, si dhe stafet përgjegjëse të shoqërive UK për Marrëdhëniet me Konsumatorin. Kjo gjë ka influencuar edhe në numrin e ulët të ankesave (9) nga konsumatorët familjarë që Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit pranë ERRU ka trajtuar gjatë vitit 2020.

Natyra e ankesave të drejtuara pranë ERRU-së ka qenë mbi “faturimin aforfe”, “zbatueshmërinë e kushteve të kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime” dhe “cilësinë e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK”. Referuar tabelës së mëposhtme, nga totali i të gjithë ankesave, katër prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

Tabela 2. Ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2020

Nr.	Objekti i Ankesës	Nr. Ankesave	Nr. Ankesave të Zgjidhura
1.	Faturimi Aforfe	4	2
2.	Zbatueshmëria e Kushteve të Kontratës	2	2
3.	Cilësia e shërbimit	3	1
TOTALI		9	5

Edhe për vitin 2020, ankesat e paraqitura në ERRU me objekt “*anulim i faturimit aforfe*” vijnë në të zënë numrin më të madh të ankesave. Shoqëritë UK nuk kanë respektuar normativat e miratuara në rastet e faturimit aforfe 4.5 m³/muaj/frymë për konsumatorët familjarë, duke faturuar kështu konsumatorët më shumë se konsumi mujor i tyre. Një nga objektivat kryesore të rregullatorit për vitin 2020 ishte bashkëpunimi me shoqëritë UK për të respektuar normativat e lejuara në raste të këtij lloji faturimi dhe për të gjetur një zgjidhje korrekte për këto lloje ankesash pa ju drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore. Zgjidhja e këtyre ankesave vazhdon të jetë një sfidë për rregullatorin për shkak të periudhës së hershme të ankimimit dhe praktikave që ndjekin shoqëritë, megjithatë ERRU për vitin 2021 do të marrë masat për ti dhënë fund këtyre lloje praktikave jo të drejta të ndërmarra nga shoqëritë UK kundrejt konsumatorëve.

Nevoja për marrjen e një shërbimi mjaft jetësor për konsumatorët si nga ana sasiore dhe cilësore ka ndikuar në shtimin e numrit të ankesave me objekt *“cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK”*. Objektet e ankimit të këtyre lloj ankesave kanë qenë të fokusuara në ofrimin e shërbimit në mënyrë të vazhdueshme apo probleme teknike për të cilën shoqëritë UK nuk kanë dhënë një zgjidhje përfundimtare të problemit të ankesës. Këto ankesa kanë gjetur një zgjidhje të kënaqshme dhe të favorshme për konsumatorët të cilët i janë drejtuar ERRU-së.

“Respektimi dhe zbatueshmëria e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në kontratën për shërbime ujësjellës kanalizime” ka qenë objekt ankimi për dy ankesa të tjera të ardhura pranë ERRU-së. Për të tilla ankesa, ERRU ka kërkuar me vendosmëri respektimin e kushteve të kontratës si instrumenti kryesor që rregullon dhe balancon në mënyrën e duhur marrëdhënien konsumator - shoqëri UK.

Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare, ERRU në zbatim të misionit të saj por edhe referuar kushteve të vështira të komunikimit që krijoi pandemia Covid – 19, nëpërmjet grupeve të punës, ka ofruar asistencë në dhënien e informacioneve, shpjegimeve dhe konsultime verbale dhe me e-mail, telefon për të gjithë konsumatorët që janë drejtuar ERRU-së për zgjidhjen e problemeve të tyre lidhur me shërbimet UK.

Në frymën e ushtrimit të kontrollit rregullator si edhe të rëndësisë dhe vëmendjes në trajtimin e problemeve të trajtimit të ankesave të konsumatorëve, me qëllim arritjen e një zgjidhje përfundimtare sidomos të atyre lloj ankesave të cilat rëndojnë konsumatorin në mënyrë të padrejtë, ERRU gjatë vitit 2020 ka zhvilluar një proces monitorimi pranë shoqërisë UK Tiranë mbi trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve drejtuar kësaj shoqërie.

ERRU ka përzgjedhur këtë shoqëri për përmirësimin e punës në drejtim të ankesave të konsumatorëve, si shoqëria më e madhe në sektorin e Ujit me mbi 1/3 e numrit të përgjithshëm të konsumatorëve në vend dhe numrin më të lartë të ankesave që i janë drejtuar edhe ERRU-së.

Në përfundim të këtij monitorimi, u hartua një raport final ku u pasqyruan gjetjet dhe rekomandimet e ERRU-së mbi procesin e trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve drejtuar UKT-së. Referuar këtij raporti, u zhvillua një takim pune me drejtuesit e shoqërisë ku u diskutua gjerësisht mbi problematikat që u konstatuan gjatë monitorimit si dhe u dhanë rekomandimet e nevojshme nga ana e ERRU-se mbi përmirësimin e këtij procesi.

Shoqërisë ju kërkua të marrë masa të menjëhershme për trajtimin e ankesave në respektim të akteve ligjore në fuqi dhe sa më afër zgjidhjes së kënaqshme për konsumatorin duke respektuar dhe zbatuar kështu edhe vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU-së për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave individuale të konsumatorëve. Në funksion të përmirësimit të procesit të trajtimit të ankesave, shoqërisë ju rekomandua riorganizimi i strukturave të brendshme të shoqërisë si dhe evidentimi dhe marrja e masave për rregullimin me investime fizike të sistemit të kanalizimeve.

Objekti i ERRU-së është zhvillimi i një praktike të unifikuar monitorimi në të gjitha shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t’u ankuar nëpërmjet një procedure korrekte ligjore, dhe që trajtimi i këtyre ankesave të gjejë një zgjidhje praktike dhe sa më të drejtë nga ana e shoqërive UK.

1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë monitorimit dhe vlerësimit të performancës së operatorëve të shërbimit UK dhe sektorit në tërësi pasi lidhet direkt me nevojën për të pasur një sektor financiarisht të qëndrueshëm, i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët.

Nisur nga kjo ERRU, që nga viti 2011 publikon përmes Raportit Vjetorë të Performancës së Sektorit UK rezultatet e monitorimit të shoqërive UK i cili ka për qëllim transparencën me të gjithë aktorët e interesuar, raport ky i cili për vitin 2019 për herë të parë u realizua me të dhënat e grumbulluara nga ERRU sipas formatit të data bazës të miratuar nga kjo e fundit.

Monitorimi jep mundësi për një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre. ERRU i ka kushtuar vëmendje forcimit të rolit të tij monitorues për sektorin duke e konsideruar atë si një element shumë të rëndësishëm në veçanti kur Shoqëritë UK aplikojnë për tarifa dhe jo vetëm.

Përmes publikimit të raportit të performancës së sektorit UK, synohet nxitja e të gjithë aktorëve në sektor si, operatorët, kryetarët e bashkive, këshillat administrative, konsumatorët, mediat si dhe vendimmarrësit politikë vendorë dhe qendrorë për t'u angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen.

Ky Raport u shpërndahet të gjitha shoqërive UK dhe aktorëve kryesorë të sektorit të ujësjellës kanalizimeve, si dhe është i disponueshëm në faqen e web-it të ERRU-së. Një formë e shkurtuar e tij në anglisht është e disponueshme po në këtë faqe web-i për të gjithë aktorët ndërkombëtarë që lidhen me sektorin përfshirë dhe shoqëritë e konsulentët e huaj.

Pjesë mjaft e rëndësishme e punës së ERRU-së për vitin 2020 krahas monitorimit të të dhënave të grumbulluara nga shoqëritë UK dhe analizës së tyre, ka qenë rritja e vëmendjes dhe monitorimit të shoqërive UK në drejtim të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërive UK, dhe veçanërisht me shoqërinë UK Tiranë që u trajtua në paragrafin 1.4.4.

1.4.6 Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore

ERRU edhe gjatë vitit 2020 bazuar në kompetencat e KKRR dhe funksioneve të tij të parashikuara në ligj, ka vijuar me punën për të përmirësuar instrumentet rregullatore që lidhen kryesisht me aplikimin për ndryshimin e tarifave. Në këtë kuadër ERRU ka rishikuar dokumentet e mëposhtme;

“Metodologjia e Vendosjes së Tarifave”. Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 18, datë 22.03.2018 vendosi “Për fillimin e procedurës për ndryshimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave”. Në vijim të këtij vendimi grupi i punës gjatë kësaj kohe konkludoi në një draft i cili tashmë ka hyrë në një fazë konkretizimi pasi me mbështetjen e Bankës Botërore po asistohet edhe nga një ekspert i huaj. Përpos rishikimit të metodologjisë dhe përshtatjen e saj me realitetin e ri në sektorin UK, një nga pikat e parashikuara është edhe përfshirja e Planit 5-vjecar të Biznesit në zbatim të metodologjisë së tarifave, i cili do të përfshijë edhe udhëzime mbi përmbajtjen e pjesëve kryesore të hartimit të një plani biznesi të cilat duhen patur në vëmendje nga shoqëritë UK.

Nisur nga sa më sipër, miratimi i metodologjisë së vendosjes së tarifave, i rishikuar, parashikohet të finalizohet gjatë vitit 2021. Vonesa në hartimin e variantit përfundimtar të metodologjisë është shkaktuar nga pandemia e COVID 19 që nuk mundëson prezencën fizike të konsulentit të huaj për vazhdimësinë dhe konkretizimin përfundimtar të asistencës së tij me stafin e ERRU-së.

“Studimi për Familjet me Ndhimë Ekonomike dhe Influenca në Qëndrueshmërinë Financiare të Shoqërive UK ” është realizuar gjatë vitit 2020 nga ERRU dhe është prezantuar gjithashtu në Konferencën Ballkanike Vjetore për Ujin të zhvilluar në Tiranë nga SHUKALB dhe SHUKOS në Nëntor 2020 përmes platformës online ZOOM.

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i influencës së arkëtimeve nga Familjet në Nevojë në qëndrueshmërinë financiare të Shoqërive UK, dhe alternativat e kompensimit për këtë kategori konsumatorësh dhe/ose për Shoqëritë UK në garantim të qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Studimi u bazua në të dhënat e marra në formë pyetësori nga shoqëritë UK mbi trajtimin dhe faturimin e kësaj kategorie nga ana e tyre, si dhe nga të dhënat e INSTAT-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nga analiza rezultoi se familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike në shkallë kombëtare përbëjnë rreth 10% e numrit total të popullsisë. Kjo përqindje e lartë përbën shqetësim sepse kjo shtresë e ka të pamundur të paguajë faturën e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve dhe ka një peshë të konsiderueshme në të ardhurat që duhet të arkëtojnë shoqëritë UK për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të tyre. Në këtë kuadër është e nevojshme që të gjendet një zgjidhje në formën e një mekanizmi kompensimi të shoqërive UK për pamundësinë e arkëtimit direkt të faturimit për këtë shtresë të popullsisë.

Në fund, studimi propozon gjithashtu mundësinë e ofrimit falas prej 50 litra/ditë për banorë, si një e drejtë humane e sanksionuar në direktivat e kombeve të bashkuara, që njëkohësisht i jep të drejtë shoqërive UK që të disiplinojnë gjithashtu abuzimet dhe shpërdorimet eventuale të ujit që mund të shkaktohen nga kjo kategori konsumatorësh. Format e kompensimit si subvencione direkte për konsumatorët e shtresave në nevojë apo shoqërive UK janë opsione që duhet të jenë subjekt analize të detajuar në nivel të qeverisë qendrore.

“Raporti i Bilancit të Ujit për Sektorin UK” hartuar për vitin 2020 për sektorin në përgjithësi dhe për çdo shoqëri UK në veçanti. Raporti i Bilancit Vjetor të Ujit për vitin 2020 u publikua në faqen e webit të ERRU-së dhe iu dërgua të gjithë Shoqërive UK. Raporti jep të dhëna dhe orientime të cilat shërbejnë për të nxjerrë konkluzione të rëndësishme dhe rekomandime në drejtim të planeve të veprimit që Shoqëritë UK duhet të ndjekin për reduktimin e Ujit pa të Ardhura, përkatësisht për përbërësit kryesor të humbjeve administrative dhe atyre fizike.

“Modeli i Monitorimit për Ankesat e konsumatorëve” ndaj shoqërisë UK Tiranë, si model praktike e unifikuar monitorimi në të gjitha shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t’u ankuar nëpërmjet një procedure korrekte ligjore, dhe që trajtimi i këtyre ankesave të gjejë një zgjidhje praktike dhe sa më të drejtë nga ana e shoqërive UK. Raporti përmban praktika dhe rekomandime përgjithësuese që do të aplikohen në të gjitha shoqëritë UK në lidhje me trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së

Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale të ERRU-së me aktorët kryesore në vend, në rajon dhe ata ndërkombëtare kanë vijuar të jenë pjesë e angazhimeve kryesore të ERRU-së përgjatë vitit 2020, pavarësisht vështirësive të krijuara nga situata e pandemisë COVID - 19. Në këtë kuadër ERRU ka shprehur qëndrimin dhe kontributin e saj në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit ujësjellës kanalizime në vend. Ajo ka qenë gjithashtu pjesë aktive e strukturave të organizatave ndërkombëtare për sektorin e ujit duke ndare me to eksperiencën e saj në këtë fushë dhe njëkohësisht për të përfituar nga eksperiencat e përparuara ndërkombëtare rregullatore.

1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë

Bashkëpunimi dhe marrëdhënia institucionale me Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2020, ka vijuar me raportimin periodik në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit të veprimtarisë institucionale të rregullatorit mbi gjendjen dhe problematikat aktuale të sektorit të ujit, si dhe të rekomandimeve për përmirësimin e performancës së tij. Në kushtet e pandemisë, bashkëpunimi me Kuvendin ka vijuar me takimet online të organizuara nga Kryetari i Kuvendit mbi situatën në vend dhe impakti që ka pasur kjo pandemi në sektor të ndryshëm, përfshirë edhe sektorin e ujit.

1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Edhe për vitin 2020 ka vijuar bashkëpunimi periodik me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për të përcjellë qasjen dhe kontributin rregullator në rishikimin e dokumenteve sektoriale në kuadër të reformës së ujit. Bashkëpunimi i këtij viti ka konsistuar në dhënien e komenteve për projektin e ardhshëm financiar nga Banka Botërore “Modernizimin e Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve”. Pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit kanë qenë edhe në komentet që ka dhënë ERRU në rishikimin e Kodit i Ujit që përfaqëson një prej dokumenteve kryesore që përcakton standardet e ofrimit të shërbimit dhe që rregullon marrëdhëniet ndërmjet ofruesit të shërbimit, pra shoqërive UK dhe Konsumatorëve.

Theksohet fakti se ERRU është institucioni i ngarkuar me ligj për hartimin e standarteve të shërbimeve ujësjellës kanalizimeve, hartimi i së cilave natyrisht duhet të realizohet në bashkëpunim me të gjithë aktorët e sektorit të ujit. Rishikimi i këtij dokumenti lindi si nevojë e dinamikës së zhvillimit të sektorit, si edhe në përgjigje të problematikave që nuk i përmbush Kodi aktual, por edhe si dokument bazë referencë për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërisë UK.

Theksohet fakti se Kodi i Ujit aktual për shkak të konjunkturave të kohës kur është hartuar në vitin 2008, ka qenë aprovuar me VKM. ERRU gjatë rishikimit të tij ka rekomanduar që në të ardhmen rishikimi i tij duhet të jetë kompetencë e ERRU për vetë natyrën mjaft teknike dhe dinamike të tij, por për faktin se nuk shpreh politika strategjike të sektorit, por përfaqëson një Rregullore, ose Kod të marrëdhënieve Shoqëri-Konsumator.

1.5.1.3 Me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Gjatë vitit 2020, ERRU ka bashkëpunuar me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të programit “Mbështetja e Negociatave Shqiptare në Mjedis”, mbështetur nga Qeveria Suedeze. ERRU ka marrë pjesë në konferencën kombëtare mbi “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Shqipëri, boshllëqet, Sfidat dhe Perspektivat në rrugën e përafrimit me BE-në. Qëllimi kryesor i konferencës ishte mbi vlerësimin e sistemit aktual të menaxhimit të mbetjeve, analizimin e politikës së BE-së, identifikimin e nevojave sa i përket planifikimit, kapaciteteve dhe përgjegjësisë të institucioneve kompetente. Në këtë konferencë u nda gjithashtu edhe përvoja e vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve kandidatë në krijimin e sistemeve të integruara të menaxhimit të mbetjeve.

1.5.1.4 Me Autoritetin e Konkurrencës

Në vijim të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës, ERRU edhe përgjatë vitit 2020 ka vijuar bashkëpunimin me këtë institucion me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjes së interesave publike në sektorin e ujit. ERRU ka marrë në konsideratë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për 2 projekt vendime për miratimin e nivelit të ri tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura dhe ia ka përcjellë ato Shoqërive UK përkatëse.

1.5.1.5 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

ERRU ka vijuar bashkëpunimin me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore si pjesë e Grupit të Punës për menaxhimin e integruar të politikave. Fokusi i bashkëpunimit të këtij viti ka qenë njohja dhe puna mbi kuadrin e ri ligjor për menaxhimin e burimeve ujore që transponon legjislacionin e BE-së, si dhe zbatimi i tij nëpërmjet planeve të menaxhimit të baseneve ujore. Paketa e re ligjore e përgatitur me asistencën teknike të projektit “Mbështetja e BE-së për Menaxhimin e Integruar të Ujit”, i bashkëfinancuar nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) do të mundësojë transpozimin e plotë të EU water acquis, si një nga kërkesat për integrimin në BE të Shqipërisë.

1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizatat ndërkombëtare është konsideruar nga ERRU si një ndër elementet kryesorë që i shërben forcimit institucional dhe kapaciteteve, kryesisht të rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj profesional në aspektet rregullatore.

1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare

ERRU si anëtare me të drejta të plota në shoqatën e rregullatorëve evropiane të ujit (**WAREG**), që nga viti 2014, edhe për vitin 2020 ka marrë pjesë aktive në veprimtaritë e zhvilluara, si në workshopet e organizuara online nëpërmjet platformës ZOOM, edhe në mbledhjet periodike të Asamblesë.

Fokusi i punës së kësaj shoqate përgjatë këtij viti ka qenë përzgjedhja e strukturës drejtuese të shoqatës si dhe promovimi i qëllimit dhe punës së kësaj shoqate pranë strukturave të Komisionit Evropian siç janë Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit dhe Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin, departamenti përgjegjës për politikën e BE-së për mjedisin.

Në asamblenë e 21-të të zhvilluar në muajin Nëntor u zhvilluan zgjedhjet e organeve drejtuese ku Kryetari i ERRU-së, Z. Ndriçim Shani u përzgjedh një nga zëvendës presidentet e kësaj shoqate. Si përfaqësues i një prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Z. Shani, krahas vendit tonë, do të përfaqësojë një zë të rëndësishëm pranë kësaj organizate në trajtimin e problemeve rregullatore dhe ato të sektorit të ujit në rajon.

ERRU mori pjesë në takimin e 15-të të Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (**NER**) të krijuar nga OECD e cila për kushtet e pandemisë u zhvillua online me pjesëmarrjen e të gjithë anëtareve të këtij rrjeti. Tematika e këtij viti, edhe pse në fokus kryesor kishte problematikat që ka shkaktuar pandemia në sektorin e ujit, ishte formësimi i rregullatorëve të së ardhmes, përshtatja e qeverisjes rregullatore me zhvillimin teknologjik në sektor. Një vëmendje të veçantë, ERRU i kushtoi edhe seminarit të Klubit të Rregullatorëve, ku fokusi i diskutimit ishte vlerësimi i performancës së rregullatorëve dhe sfidat e tyre.

Përgjatë vitit 2020, një bashkëpunim i veçantë ka qenë përfshirja e ERRU-së si pjesë Task Force të rregullatorëve të iniciativës “*Rregullimi i ofrimit të shërbimit gjithëpërfshirës për kanalizimet në Qytete (CWIS)*” organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (**IWA**). Kjo iniciativë synon identifikimin e nevojave, mundësive dhe mjeteve për veprim për të mbështetur dhe frymëzuar rregullatorët në kontributin e tyre në arritjen e ofrimit gjithëpërfshirës të shërbimit të kanalizimeve në të gjithë qytetin në kontekstin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo iniciativë e re e IWA nxjerr në pah rregullatorët si drejtues të rëndësishëm të cilët pozicionohen në mënyrë unike për të përkthyer qëllimin e gjerë të politikës kombëtare në korniza të qarta të performancës dhe llogaridhënies për ofruesit e shërbimeve dhe janë në gjendje të ofrojnë udhëzimet dhe mbikëqyrjen e nevojshme.

Edhe për vitin 2020, ERRU vijoi bashkëpunimin me **Programin e Ujit për Rajonin e Danubit** të mbështetur nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive Ujësjetëlës Kanalizime. Bashkëpunimi i këtij viti ka qenë pjesëmarrja në Forumin e Danubit për Ujin ku tematika e këtij viti ishte “Rëndësia e të dhënave të sektorit të ujit në epokën dixhitale”. Theksi i këtij forumi ishte diskutimi mbi sigurimin dhe saktësinë e të dhënave në sektorin e ujit si një bazë e domosdoshme për hartimin e politikave inteligjente, shërbimeve të sigurt dhe të qëndrueshme në rajonin e Danubit. Ky forum u ndoq me mjaft interes nga rregullatori duke qenë se saktësia e të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK ende vijon të jete problematike në sektorin e ujit në Shqipëri. Gjithashtu këtë vit, Kryetari i ERRU-së, Z. Shani është përzgjedhur si një nga zërat kryesor në këtë program dhe në platformën online “*Zëri i Danubit*”.

1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtar dhe Ndërkombëtar

Si një nga aktorët kryesor në sektor, ERRU ka vijuar bashkëpunimin dhe kontributin aktiv në programet e financuara nga Qeveria Gjermane të zbatuar nëpërmjet **GIZ**, me projektin për “Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të orientuara drejt performancës dhe konsumatorëve”. Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit 2020 është finalizuar “Portali për Konsumatorët” një platformë online e cila do i mundësojë çdo konsumatori të marrë një informacion të detajuar mbi shoqërinë UK të qytetit të tij dhe gjithashtu një hallkë tjetër ku mund të drejtojnë ankesat për shërbimet e ofruara nga shoqëritë UK. ERRU ka pasur një rol mjaft aktiv me takime, dhënie komente dhe prezantime të ndryshme deri në zbatim të këtij projekti.

Gjithashtu, po me mbështetjen e GIZ, gjatë vitit 2020 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka financuar kontratën për “Rishikimin e Kodit të Ujit”. ERRU si një nga aktorët kryesor në vendosjen e standardeve të operimit në sektorin UK por edhe në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga ana e rregullatorit për nevojën që ka rishikimi i këtij dokumenti, ka qenë pjesëmarrës dhe ka dhënë kontributin e tij të deritanishëm në mbështetje të zhvillimit të këtij procesi.

Gjatë vitit 2020 në kuadër të marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit ERRU ndoqi Konferencën dhe Ekspozitën e përbashkët të organizuara nga **SHUKALB dhe SHUKOS** ku tematika e këtij viti ishte **“Uji dhe Ndryshimet Klimatike”**. Në konferencë u trajtuan një larmishmëri temash që mbulojnë të gjithë aspektet e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime duke përfshirë ato menaxheriale dhe teknike. ERRU u prezantua në këtë konferencë me një temë shumë sensitive dhe të mbështetur në studimin e kryer nga ERRU “Familjet me Ndihmë Ekonomike - Influenca në Qëndrueshmërinë Financiare të Shoqërive UK”.

1.5.2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERRU-së

ERRU për vitin 2020, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar me rregullatorët ndërkombëtarë që operojnë në sektorin e ujit, kishte planifikuar të zhvillonte aktivitete, workshope e takime pune me karakter bilateral dhe në frymën e shkëmbimit të eksperiencave.

Për shkak të situatës së krijuar nga Covid 19 nuk u realizuan plotësisht objektivat e parashikuara në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me rregullatorët ndërkombëtarë. Në respektim të masave anti covid janë zhvilluar takime të vazhdueshme pune me rregullatorin e Kosovës (ARRU) ku janë shprehur shqetësimet dhe impaktin që ka pasur kjo pandemi në sektorin e ujit dhe vështirësitë që solli në menaxhimin e shoqërive UK.

1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median

Enti Rregullator i Ujit ka si pjesë të përgjegjësi gjatë veprimtarisë transparencën, si një element ky i domosdoshëm për të siguruar besueshmërinë dhe integritetin e institucionit. Shpeshherë transparenca kuptohet si akses në informacionin publik dhe në këtë kuptim ERRU përditëson rregullisht faqen zyrtare elektronike, si dhe garanton dhënien e informacionit të kërkuar kujtdo që i drejtohet institucionit.

Gjatë vitit 2020, dy kërkesa për informacion iu drejtuan ERRU-së të cilat u trajtuan sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin për të drejtën e informimit, duke përcjellë informacionin e kërkuar. Kërkesat pranë ERRU paraqiten nëpërmjet postës, postës elektronike dhe portalit pyetshtetin.al.

Transparenca është pjesë integrale e punës së ERRU si në çështjet e rregullimit të sektorit UK, ashtu edhe në administrimin e brendshëm të institucionit. Në drejtim të rregullimit të sektorit, transparenca e ERRU-së nuk kufizohet vetëm me publikimin e vendimmarrjes së KKRR mbi licencimin dhe tarifat. Publikimi i përvitshëm i Raportit të Performancës së shoqërive UK dhe i Bilancit të Ujit ka rritur nivelin e transparencës në sektor dhe ka bërë të mundur që publiku të ketë informacion si performon shoqëria që i ofron shërbimin ujësjellës kanalizime, dhe si performon ajo krahasuar me shoqëri të tjera UK në vend. Në drejtim të transparencës mbi administrimin e brendshëm të institucionit, ERRU

publikon në mënyrë periodike të dhëna mbi buxhetin, monitorimin financiar, prokurimet, auditimet, vendet e lira të punës, etj.

ERRU beson se transparenca është një shtysë e fortë që ndihmon në arritjen e vizionit të institucionit dhe mungesa e saj do ta pengonte realizimin e detyrave thelbësore si mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe gjetjen e një ekuilibri të drejtë mes interesave të tyre, qeverisjes dhe investitorëve.

Në përmbushje të detyrave të lëna nga Kuvendi me rezolutën e vitit 2019, ERRU hapi faqen zyrtare të institucionit në rrjetin social Facebook, si një mënyrë e mirë jo vetëm e informimit të publikut por edhe e ndërveprimit me të. Kjo faqe përditësohet rregullisht me informacione dhe raporte mbi sektorin ujësjellës kanalizime dhe aktivitetin e ERRU, vendimmarrjen e KKRR, si dhe aktivitete në të cilat institucioni është pjesë.

Gjithashtu ERRU i kushton një vëmendje të veçantë marrëdhënies së bashkëpunimit me mediat vizive dhe audio vizive në vend. Ndaj edhe përgjatë këtij viti, ERRU ka qenë pjesëmarrëse në intervista me median kombëtare (Top Channel) për të prezantuar dhe përcjellë tema mjaft sensitive për konsumatorin siç është gjendja e sektorit UK në këndvështrimin rregullator dhe nevojat e përmirësimit të këtij sektori në të ardhmen.

1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

1.7.1 Të Ardhurat

Referuar ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 për kuadrin rregullator të sektorit UK, pagesat rregullatore të operatorëve që operojnë në sektorin UK dhe ato për liçensimin e tyre përbëjnë burimin e vetëm të financimit në ERRU. ERRU ka nënshkruar kontrata me operatorët bazuar në tarifat e miratuara, ku është përcaktuar tarifa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit të saj. Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2020, mbështetur në kontratat që aktualisht ERRU ka me 41 shoqëri UK, është në shumën 51.689.786 lekë.

Arkëtimet totale të ERRU-së të realizuara gjatë vitit 2020 janë në shumën 54.440.928 lekë, nga të cilat 54.100.928 lekë janë pagesa rregullatore dhe 340.000 lekë janë nga tarifat e licencimit. Realizimi i arkëtimeve sipas zërave përkatës jepen në Tabelën 3.

Tabela 3. Realizimi i Arkëtimeve Sipas Zërave

Nr.	Emërtimi i të Ardhurave	Vlera
1	Nga Pagesat Rregullatore të prapambetura	24 284 463
2	Nga Pagesat Rregullatore të vitit 2020	29 816 465
3	Nga Pagesat e Licencimit	340 000
Totali		54 440 928

Për mbledhjen e detyrimeve të mbartura nga shoqëritë UK gjatë vitit 2020 është kërkuar nga operatorët nëpërmjet shkresave përmbushja e detyrimit, si dhe është rënë dakort që sipas një aktmarrëveshje ato të shlyhen me këste sepse përgjithësisht ato përbëjnë vlera të konsiderueshme. Gjithashtu janë në proces ekzekutimi nga zyra e përmbarimit disa shoqëri të cilat nuk kanë ekzekutuar vullnetarisht detyrimin sipas vendimit gjyqësor.

Në vijimësi ERRU ka treguar kujdes të veçantë në përcaktimin e pagesave rregullore vjetore në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat e operatorëve që operojnë në sektorin UK.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt, si për shkak të vlerës së vogël të saj, edhe sepse ajo është kusht paraprak për t'u licencuar.

Likuiditetet në vitin 2020 garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit për vitin 2021 të Entit, duke mbuluar tërësisht shpenzimet e parashikuara vjetore.

1.7.2 Shpenzimet Operative


Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dhe rregullores së brendshme të ERRU "Për menaxhimin e aktiveve".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2020, është miratuar VKM nr. 709, datë 06.11.2019, ku fondi i miratuar për shpenzimet operative është 49 287 733 lekë.

KKRR me vendimin nr. 5, datë 13.01.2020, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave në zëra të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të ERRU-së, si dhe zhvillimin e funksionimit normal të veprimtarisë së përditshme të saj.

Plani vjetor është detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime sipas raporteve në përqindje që jepen në Grafikon 2.



Grafiku 2. Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative të Vitit 2020

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2020, janë në shumën 38.727.133 Lekë, ose 79 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative.

Arsyet e mosrealizimit 21 % të fondit të parashikuar janë, si më poshtë:


- Mbyllja dhe kufizimi nga pandemia Covid-19 e cila ka ndikuar kryesisht në mosrealizimin e zërit Shërbime dhe Furniturë;
- Tre vende vakante përgjatë gjysmës së parë të vitit 2020 që kanë ndikuar në mosrealizimin e zërit Fondi i Pagave dhe për rrjedhojë zërit Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shpenzimet e kryera të detajuara në zëra dhe vlera paraqiten në Tabelën 4

Tabela 4 Shpenzimet sipas zërave për vitin 2020

Nr.	Zërat e Shpenzimeve	Vlera (në lekë)
1	Pagat e punonjësve	27 348 933
2	Sigurime shoqërore e shëndetësore	4 409 562
3	Shërbime e furniturë	6 853 638
4	Investime	120 000
5	Totali	38.732.133 lekë

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU krahasuar me shpenzimet e realizuara paraqitet në vijim në Grafikon 3.



Grafiku 3. Plani i Shpenzimeve të Miratuara nga KM krahasuar me Shpenzimet e Realizuara

2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2020

Rezoluta e Kuvendit referuar Raportit të Aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit, për vitin 2019 përcakton angazhimet në drejtim të institucionit të ERRU-së për vitin 2020, realizimi i të cilave cituar sipas numrit rendor që jepen në të, rezulton si më poshtë:

1. **ERRU duhet të bëjë më shumë për realizimin e shembujve pilot të agregimit (bashkimit) të disa shoqërive UK në sektor dhe të shfrytëzojë “ Platformën Ndërinstitucionale Online”, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë, e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri, që synon rritjen e autoritetit të institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare për të bërë të mundur realizimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura për qeverinë.**

ERRU ka ngritur në mënyrë të vazhdueshme nevojën e agregimit të sektorit UK si një sektor mjaft i fragmentarizuar ku në mbyllje të vitit 2019 (të dhënat e përditësuara për vitin 2020 do të jepen në Raportin e Veprimtarisë së ERRU në fund të janarit 2021) rezulton se vetëm 14 shoqëri UK nga 57 që operojnë në sektor arrijnë të mbulojnë kostot O&M dhe vetëm 4 prej tyre arrijnë të mbulojnë kostot Totale.

ERRU vazhdimisht në të gjitha raportet vjetore që publikon për sektorin, si dhe në takimet e ndryshme me aktorët e qeverisë qendrore ka theksuar fort rekomandimin e saj ku procesi i agregimit të sektorit UK si avantazh i ekonomisë së shkallës duhet të bëhet sipas principit në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore duke synuar që fillimisht të bëhen 2-3 agregime të suksesshme.

Akoma nuk konstatohet ndonjë pozicionim konkret nga qeveria qendrore për mënyrën dhe formën e agregimit, ndërsa qasja e propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë që është përfshirë edhe në projekt-ligjin e sektorit të ujit nënkupton që agregimi të realizohet me anë të Strukturave të Subjekteve të Përbashkëta dhe detyruese. Ky lloj agregimi presupozon një agregim më tepër në formë centralizimi të sektorit sesa një agregim shkallë-shkallë. Centralizimi i sektorit mbart në vetvete mjaft paqartësi që nevojiten të analizohen me kujdes para marrjes së një vendimi përfundimtar për këtë proces.

Gjatë vitit 2020 ERRU nuk ka arritur që rekomandimin e mësipërm ta adresojë përmes Platformës Ndërinstitucionale Online pasi akoma nuk i është dhënë akses në përdorimin e saj megjithë kërkesën e bërë nga ERRU.

2. **Duke patur parasysh që “Uji Pa të Ardhura” vijon të mbetet në nivele tepër të larta dhe problem serioz për qëndrueshmërinë e shumë shoqërive UK, ERRU duhet të intensifikojë punën për gjetjen e rrugëve të reja efektive dhe konkrete lidhur me këtë problem. Akoma më shumë shqetësuese bëhet kjo situatë kur vërejmë që nuk ka përmirësim nga viti në vit, me gjithë miratimin e tarifave të reja nga ERRU-ja.**

Treguesi Uji Pa të Ardhura (UPA) vazhdon të mbetet një shqetësim serioz për sektorin UK, pasi hapat e ndërmarrë nga shoqëritë UK nuk kanë reflektuar përmirësime të ndjeshme.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë këtij treguesi duke publikuar Raportin Vjetor të Bilancit të Ujit për të gjitha shoqëritë UK, në të cilin paraqitet niveli i humbjeve për çdo shoqëri, arsyet që shkaktojnë

këto humbje dhe masat që duhen të marrin për reduktimin e tyre. ERRU vazhdon në mënyrë sistematike të rrisë kërkesën dhe të asistojë Shoqëritë UK për të hartuar një Bilanc Uji sa më real dhe të detajuar. Progresi në këtë drejtim nga ana e shoqërive UK është i dukshëm në dy vitet e fundit.

Nisur nga fakti se humbjet e ujit lidhen direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK, në procesin e aplikimit për nivel të ri tarifar, ERRU analizon në detaje, treguesin UPA mbështetur në analizat e bilanceve të ujit dhe vendos më tej objektiva konkrete dhe ambicioze. Konkretisht gjatë vitit 2020, ERRU ka vendosur objektiva ambicioze për reduktimin e UPA për shoqëritë UK Pogradec, Fier, Patos dhe Peqin, të cilat i janë bashkëngjitur Vendimit të KKRR për tarifat e reja të aprovuara për to. Objektivat e vendosura në vendimet e tarifave të miratuara gjatë vitit 2020 paraqiten në tabelën 5 të mëposhtme.

Tabela 5. Treguesi i Ujit Pa të Ardhura

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit 2019 (në %)	Propozimi i shoqërisë Viti 2021 (në %)	Objektivi i vendosur nga ERRU Viti 2021 (në %)
1	UK Pogradec	35.4	40.3	33.3
2	UK Peqin	67.5	63	60
3	UK Fier	72.3	72	69
4	UK Patos	I pamundur për vlerësim për zonën e re të shërbimit	65.4	60

Nga tabela shihet qartë që objektivat e vendosura nga ERRU për shoqëritë e mësipërme në drejtim të uljes së Ujit Pa të Ardhura, për vitin 2021 janë ambicioze duke patur parasysh mundësitë reale që kanë shoqëritë për rregullimin e këtij treguesi. Reduktimi i humbjeve të ujit, përveç një menaxhimi të mirë të sistemeve të furnizimit me ujë është i lidhur ngushtë dhe me nevojën e investimeve të reja fizike, kryesisht në zonat rurale, të cilat kanë në administrim sisteme furnizimi shumë të amortizuara. Përmirësimi i Treguesit Uji Pa të Ardhura, mbetet një nga prioritetet kryesore të punës së ERRU-së dhe subjekt i monitorimit të vazhdueshëm prej saj.

3. **Në kushtet kur vihet re që shoqëritë UK janë të mbingarkuara me staf të punësuar jashtë nevojave reale dhe profesionalizmit, ERRU gjatë miratimit të tarifave të kërkojë me rigozitet nga shoqëritë UK argumentim të plotë e të saktë për numrin e punonjësve, përshkrimin e detajuar të punës për secilin pozicion të stafit të saj dhe të refuzojë kostot shtesë të pajustificuara për stafin e shoqërive UK. Rasti i UK Lushnje duhet të aplikohet për të gjitha shoqëritë UK që kërkojnë shtesë stafi të pajustificuar. Ndërkohë, lidhur me rekomandimin për alokimin e fondeve nën përgjegjësinë e Agjencisë Kombëtare të Ujit dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) për garantimin e sigurisë së objekteve me kamera sigurie, gjë e cila do të sillte një lehtësim të stafit të shoqërive UK, të shfrytëzojë "Platformën Ndërinstitucionale Online".**

ERRU i kushton një vëmendje të veçantë efijencës së stafit për 1000 lidhje si një tregues shumë i rëndësishëm i cili është një nga zërat me peshën kryesore në kostot e shoqërive UK. Gjatë aplikimeve për nivel të ri tarifar nga ana e shoqërive UK, ERRU, analizon me shumë kujdes organigramën e

shoqërive në mënyrë që kjo të jetë sipas nevojave reale të shoqërisë dhe jo e mbingarkuar me staf, fenomen ky që ndodh rëndom në shoqëritë UK. ERRU në çdo rast gjatë analizës tekniko – ekonomike për tarifat e reja të propozuara nga shoqëritë përjashton kostot e pajustificuara të stafit duke vendosur objektivat dhe rekomandimet përkatëse për këtë tregues.

Tabela 6. Treguesi i Efiçencës së Stafit për 1000 lidhje

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit	Propozimi i	Objektivi i vendosur
		2019 (në %)	shoqërisë Viti 2021 (në %)	nga ERRU Viti 2021 (në %)
1	UK Pogradec	4.5	5.4	5.4
2	UK Peqin	22.8	15.4	15.4
3	UK Fier	6.26	6.26	6.26
4	UK Patos	24.3	10.8	10.8

Nga tabela shihet se për shoqërinë UK Pogradec objektivi i propozuar nga shoqëria UK si dhe ai i vendosur nga ERRU janë në rritje. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të stafit me 32 punonjës mbas riorganizimit në përputhje me reformën, ku janë shtuar në administrim edhe zonat e reja rurale të shërbimit.

UK Peqin dhe UK Patos, siç shihet edhe nga tabela, kanë parashikuar një përmirësim të dukshëm të efiçencës së stafit. Për shoqërinë UK Peqin, megjithëse nuk do të ketë ndryshim të numrit të punonjësve, përmirësimi në këtë rast vjen si rezultat i shtimit të klientëve, përkatësisht me 285 lidhje furnizimi me ujë dhe 1,615 lidhje kanalizime të ujërave të ndotura, shërbim i cili iu ofrohet për herë të parë. Për UK Patos ndikimi vjen si rezultat i reduktimit të stafit me 15 punonjës më pak nga 145 në 130 si dhe i shtimit të numrit me 515 lidhje të reja furnizimi me ujë dhe 5,672 lidhje kanalizime të ujërave të ndotura, si shërbim i cili iu ofrohet këtyre klientëve për herë të parë.

Në rastin e shoqërisë UK Fier është pranuar të mbahet i njëjti nivel i efiçencës së stafit nisur kjo edhe nga analiza e bërë në këtë drejtim, nga e cila ka rezultuar se shoqëria për momentin e ka të pamundur përmirësimin e këtij treguesi për vitin 2021.

ERRU vazhdon ti mbetet rekomandimit të saj për nevojën e mbështetjes me fonde për shoqëritë UK sa i përket garantimit të sigurisë së objekteve me kamera sigurie që do të ndikonte në uljen e numrit të stafit në shoqëritë UK dhe si rrjedhojë edhe në uljen e kostos së këtij zëri. Gjatë vitit 2020 ERRU nuk ka arritur ta adresojë këtë problematikë në Platformën Ndërinstitucionale Online pasi nuk ka patur akses.

4. **ERRU të jetë aktive në përditësimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të saj përmes “Platformës Ndërinstitucionale Online”, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë, platformë e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri që synon rritjen e autoritetit të institucioneve të pavarura, si dhe përfshirjen e Kuvendit të Shqipërisë si katalizator ndërmjet institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare për të bërë të mundur realizimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura për qeverinë.**

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë për rezolutën e vitit 2020 mbi përditësimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të "Platformës Ndërinstitucionale Online, ERRU ka vijuar komunikimin me strukturën e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke shprehur gatishmërinë për të qenë pjesë integrale e kësaj strukture dhe shfrytëzimin e saj për të ushtruar autoritetin e saj rregullator në sektorin e ujit.

Gjatë vitit 2020 nuk është mundur aksesi në Platformën Ndërinstitucionale Online për ERRU-në.

5. **Për eliminimin e problemeve të licencimit të shoqërive UK për plotësimin e kushteve të akt miratimit të lejes higjeno-sanitare dhe të inspektimeve që lidhen me to, në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar Shtetëror, të merren masa për propozimin e ndryshimeve përkatëse ligjore. Theksojmë se ky shqetësim është kërkuar të adresohet në mënyrë të përsëritur në rezolutat e miratuara dhe ende nuk ka gjetur zgjidhje.**

Problematika e licencimit për disa shoqëri UK mbetet e dukshme edhe për vitin 2020, kryesisht për shkak të mosplotësimit të kushteve për marrjen e lejeve higjeno sanitare, e cila akoma nuk ka gjetur zgjidhje për realizimin e saj në praktikë.

ERRU e ka ngritur këtë çështje në mënyrë të vazhdueshme pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si edhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. ERRU ka dhënë propozime konkrete për rishikimin e akteve nënligjore aktuale mbi dhënien e Akt Miratimeve Higjeno Sanitare, prej të cilave varet ngushtësisht dhe detyrimisht licencimi i shoqërisë UK për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura që ato i ofrojnë popullsisë.

Marrja në konsideratë e kësaj problematike gjatë vitit 2020 ka qenë pothuajse e pamundur për shkak të Covid-19 sepse strukturat institucionale që lidhen me to kanë qenë tërësisht të fokusuar në drejtim të luftës kundër pandemisë. Gjithsesi ERRU në muajin Dhjetor 2020 organizoi një takim me zv. Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë z. Hantin Bonati posaçërisht për këtë çështje ku u mor angazhim nga ana e tij për të organizuar një takim tjetër me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për të avancuar me hapa konkrete për zgjidhjen e këtij problemi.

Për sa më sipër, mendojmë që ky rekomandim duhet të mbetet në rezolutën e vitit 2021 në mënyrë që ti jepet vëmendja dhe rëndësia e duhur për zgjidhje sa më të shpejtë ndërinstitucionale.

6. **Duke qenë se treguesi " Norma e Arkëtimit" vijon të mbetet i pa përmirësuar në tre vitet e fundit, ERRU duhet të intensifikojë punën për gjetjen e rrugëve të reja efektive dhe konkrete për rritjen e normës së arkëtimit nga shoqëritë UK, si një tregues i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK.**

"Norma e Arkëtimit" është një tregues shumë i rëndësishëm i cili lidhet drejtpërsëdrejti me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK. ERRU gjatë analizës së shoqërive UK kur aplikojnë për nivel të ri tarifor i jep një rëndësi të veçantë normës së arkëtimit korrente dhe asaj të përgjithshme. Përgjithësisht theksi dhe objektivat që vendosen nga ERRU gjatë analizës së aplikimeve për nivel të ri tarifor jepen për Normën e Arkëtimit Korrente në mënyrë që të nxitet mbledhja e arkëtimit të vitit dhe të mos rritet më tej niveli i detyrimeve të prapambetura.

Një gjë e tillë është ndjekur edhe në aplikimet e shoqërive që kanë aplikuar për nivel të ri tarifor gjatë vitit 2020 si në tabelën 7 të mëposhtme.

Tabela 7. Treguesi i Normës së Arkëtimit Korrente

Nr.	Operatori	Treguesi i Vitit 2019 (në %)	Propozimi i shoqërisë Viti 2021 (në %)	Objektivi i Vendosur nga ERRU Viti 2021 (në %)
1	UK Pogradec	81	82	84
2	UK Peqin	87	90	90
3	UK Fier	83	84	85
4	UK Patos	I pamundur për vlerësim për zonën e re të shërbimit	70.2	74

Nga tabela shihet qartë që objektivi i vendosur nga ERRU në drejtim të Normës së Arkëtimit Korrente përgjithësisht është me agresiv nga ai i shoqërive UK me përjashtim të shoqërisë UK Peqin i cili është i njëjtë me atë të propozuar nga shoqëria, e cila është dakordësuar nga ERRU pas një analize të detajuar të këtij treguesi për këtë shoqëri.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme do të vijojë të vendosë theksin në përmirësimin e Normës së Arkëtimit nga shoqëritë UK duke u treguar agresive në objektivat që do të vendosen në vijim për to.

7. **Të vijojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët në sektor sa u takon ndryshimeve ligjore. Këto ndryshime ligjore janë të domosdoshme, pasi, ndër të tjera, pritet të sjellin një përcaktim më të qartë të statusit ligjor të ERRU-së, si dhe një dimension të ri lidhur me rolin e tij si institucion i pavarur në sektorin UK, por këto vijnë të vonohen për të disatin vit radhazi.**

Ndryshimet ligjore në drejtim të konsolidimit të statusit ligjor të ERRU-së si institucion i pavarur, megjithëse duhet të ishin realizuar më vete në amendimin e ligjit Nr. 8102 për ERRU-në, ato u përfshinë në draftin e ligjit për Sektorin e Ujit, draft i cili akoma nuk ka përfunduar procesin e shqyrtimit të tij nga Këshilli i Ministrave dhe më tej nga Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Ende nuk kemi informacion në lidhje me vazhdimësinë e këtij procesi në të cilin varen dhe ndryshimet ligjore të domosdoshme për institucionin e ERRU-së.

8. **ERRU duhet të intensifikojë punën e saj për të bërë të mundur promovimin e institucionit përmes mjeteve të informimit publik, si dhe mediave sociale, ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre, si dhe për të rritur besimin e konsumatorëve tek ERRU-ja për mbrojtjen e interesave të tyre. Fakti që kemi vetëm 18 ankesa në vit nga konsumatorët (krahasuar me 39 ankesa një vit më parë), ndërkohë që dihen problematikat me të cilat përballen konsumatorët në këtë sektor, tregon që mbetet akoma shumë për të bërë.**

Përgjatë vitit 2020 ka intensifikuar përpjekjet për promovimin e institucionit duke ofruar me transparencën e duhur informacione të detajuara mbi zhvillimet, vendim-marrjet dhe aktivitetin e ERRU-së. ERRU e konsideron transparencën si një element mjaft të rëndësishëm për realizimin e vizionit të saj dhe të gjetjes së një ekuilibri të drejtë dhe realist midis mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

Në përmbushje të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi me rezolutën e vitit 2020, ERRU hapi faqen zyrtare të institucionit në rrjetin social Facebook, si instrument shtesë për informimin e publikut dhe të ndërveprimit me të. Kjo faqe përditësohet rregullisht me informacione dhe raporte mbi sektorin ujësjellës kanalizime, aktivitetin dhe vendim-marrjen e KKRR, si dhe pasqyrimin e aktiviteteve të ndryshme të sektorit në të cilat institucioni ka qenë pjesëmarrës.

Pjesë mjaft e rëndësishme e promovimit të rolit rregullator të institucionit të ERRU ka qenë rritja e vëmendjes dhe kontributit të saj në drejtim të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërive UK. Në këtë kuadër ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me shoqëritë UK duke rekomanduar dhe zgjidhjen sidomos ato lloj ankesash të cilat kanë pasur një interpretim të gabuar të referencave ligjore nga ana e shoqërive UK.

Konkretisht për të kontribuar për arritjen e një zgjidhje përfundimtare sidomos të atyre lloj ankesave të cilat rëndojnë konsumatorin në mënyrë të padrejtë, dhe në frymën e ushtrimit të kontrollit rregullator, ERRU ka zhvilluar një proces monitorimi pranë shoqërisë UK Tiranë mbi trajtimin e ankesave. ERRU ka përzgjedhur këtë shoqëri për përmirësimin e punës në drejtim të ankesave të konsumatorëve, si shoqëria më e madhe në sektorin e Ujit me mbi 1/3 e numrit të përgjithshëm të konsumatorëve në vend, që natyrisht në total ka edhe numrin më të lartë të ankesave që i janë drejtuar shoqërisë edhe ERRU-së.

Referuar këtij monitorimi me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në raportin përkatës nga grupi i punës, u zhvillua një takim pune me drejtuesit e shoqërisë ku u diskutua dhe ju kërkua shoqërisë të marrë masa të menjëhershme për trajtimin e ankesave në respektim të akteve ligjore në fuqi dhe sa më afër zgjidhjes së kënaqshme për konsumatorin.

Objekti i ERRU-së është zhvillimi i një praktike të unifikuar monitorimi në të gjitha shoqëritë UK me qëllimin kryesor mbrojtjen e konsumatorit në këndvështrimin e së drejtës së tij për t'u ankuar nëpërmjet një procedure korrekte ligjore, dhe që trajtimi i këtyre ankesave të gjejë një zgjidhje praktike dhe sa më të drejtë nga ana e shoqërive UK.

9. **Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorëve të tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve.**

ERRU ka ofruar gjithnjë kontributin dhe bashkëpunimin e saj në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve me të gjithë aktorët në sektorin e ujit, si Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqatën Ujësjellës Kanalizime të Shqipërisë, AKUM, AMBU etj.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si Ministri përgjegjëse e linjës për sektorin e ujësjellës kanalizimeve konsideron si një nga elementët kryesorë për përmirësimin e performancës së sektorit lidhjen e Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe secilës nga shoqëritë përkatëse UK, e cila bazohet në tregues performance të caktuara.

Realizimi i këtyre treguesve të performancës do të shërbejë si bazë vlerësimi për dhënien e subvencioneve dhe të incentivave për investime fizike nga qeveria qendrore këtyre shoqërive nëpërmjet AKUM-it.

ERRU ka rekomanduar gjithnjë përfshirjen e saj në këtë proces si institucioni ligjor dhe kompetent i cili merret direkt me vlerësimin e performancës së shoqërive UK nëpërmjet Treguesve Kryesore të Performancës, por që akoma nuk është marrë në konsideratë.

Nga ana tjetër ERRU, siç është theksuar në paragrafët e mësipërm, vazhdon të japë kontributin e saj për përmirësimin e performancës së sektorit në vendosjen e objektivave për shoqëritë UK që aplikojnë për tarifa të reja nëpërmjet treguesve kryesorë të performancës sa më reale dhe njëkohësisht ambicioze. Do të ishte e nevojshme që ky kontribut i kufizuar vetëm kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja të mund të shtrihej në praktikë për të gjithë shoqëritë UK.

10. **Të punojë për hartimin e një udhëzuesi dhe modeli të unifikuar të Planit 5-vjeçar të Biznesit për shoqëritë UK, duke marrë për bazë praktikën më të mira të vendeve Europiane.**

ERRU aktualisht ka hyrë në fazën e konkretizimit të rishikimit të Metodologjisë së Tarifave ku ka kontraktuar edhe një ekspert të huaj nëpërmjet kontributit të Bankës Botërore për të finalizuar këtë proces. Një nga pikat e parashikuara është edhe përfshirja e Planit 5-vjeçar të Biznesit në zbatim të metodologjisë së tarifave i cili do të përfshijë edhe udhëzime mbi përmbajtjen e pjesëve kryesore të hartimit të një plani biznesi të cilat duhen patur në vëmendje nga shoqëritë UK.

Njëkohësisht ERRU ka rënë dakord me përfaqësuesit e Projektit të Bankës Botërore në përfshirjen e projektit “Për programin e modernizimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve” të hartimit të një modeli të unifikuar Plan Biznesi 5 vjeçar për të gjithë sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Projekti i mësipërm pritet së shpejti që të firmoset nga qeveria shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Financave.

3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi

ERRU si aktor kryesorë në sektorin UK, në mënyrë të vazhdueshme luan një rol proaktiv duke dhënë kontributin e tij me rekomandime konkrete për përmirësimin e sektorit UK në adresë të qeverisë qendrore nisur kjo nga eksperiencia 22 vjeçare si institucion, si dhe njohuritë e thella që ka për sektorin. Në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin 2019, të dërguar pranë Këshillit të Ministrave dhe të prezantuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë nga Kryetari i ERRU, si dhe në raportin e performancës për shoqëritë UK të vitit 2019, janë dhënë disa rekomandime të cilat kërkojnë domosdoshmërisht ndërhyrjen dhe mbështetjen e qeverisë qendrore.

Rekomandimet e dhëna nga ERRU konsistojnë kryesisht në disa pika konkrete të nevojshme për t'u ndërmarrë në konsideratë nga qeveria qendrore për përmirësimin e sektorit UK në vendin tonë të cilat ishin:

- Rishikimi dhe aprovimi i ndryshimeve të ligjit nr. 8102 për Entin Rregullator të Ujit të propozuara nga ERRU në Kuvendin e Shqipërisë, pavarësisht miratimit ose jo të projekt-ligjit për sektorin e ujit në forcim të rolit si institucion i pavarur për përmirësimin e performancës së sektorit.
- Shfuqizimi i Kodit aktual të Ujit (Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime ujësjellës kanalizime) dhe rishikimi dhe aprovimi i tij nga ERRU, si domosdoshmëri në përgjigje të kërkesave aktuale të sektorit, dhe në veçanti për një marrëdhënie dhe trajtim sa më objektiv e racional të ankesave të konsumatorëve.
- Hartimi i akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjeno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i nënakteve të mësipërme do të shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rriskut të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, si një domosdoshmëri për zgjidhjen e problemit të licencimit të shoqërive UK.
- Të nisë sa më shpejt të jetë e mundur procesi i agregimit të Shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës bazuar në principin “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme, ku ERRU duhet të para vlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Të nxitet përmirësimi i performancës së Shoqërive UK nëpërmjet hartimit të Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive bazuar në Tregues Performance dhe Objektiva të vlerësuara në përputhje me gjendjen reale të Shoqërive UK dhe ambicioze për të ardhmen.
- Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për mjaft shoqëri UK. Shoqëritë e dobëta financiarisht duhet të mbështeten nga qeveria qendrore për instalimin e matësve të ujit në burim dhe konsumatorët familjarë në mënyrë që të hartohen bilanci i ujit të saktë si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Të përditësohet Master Plani Kombëtar i Sektorit të UK për të përfshirë në të nevojat për investime edhe të zonave të reja rurale që më parë kanë qenë jashtë zonës së shërbimit të shoqërive UK dhe ndryshimet të cilat duhet të reflektohen edhe në draftin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve.

Nisur nga rekomandimet e mësipërme konstatohet se gjatë vitit 2020 kanë filluar diskutimet konkrete për rishikimin e Kodit të Ujit i cili po rishikohet me mbështetjen e GIZ të udhëhequr nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Si dokument pune rutinë për të, ERRU ka marrë pjesë me komente dhe sugjerime të nevojshme për tu marrë në konsideratë në Kodin e Ri të Ujit.

Në lidhje me çështjen e hartimit të akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, ERRU e ka ngritur këtë çështje në mënyrë të vazhdueshme pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si edhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. ERRU ka dhënë propozime konkrete për rishikimin e akteve nënligjore aktuale mbi dhënien e Akt Miratimeve Higjeno Sanitare, prej të cilave varet ngushtësisht dhe detyrimisht licencimi i shoqërisë UK për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura që ato i ofrojnë popullsisë.

Marrja në konsideratë e kësaj problematike gjatë vitit 2020 ka qenë pothuajse e pamundur për shkak të Covid-19 sepse strukturat institucionale që lidhen me to kanë qenë tërësisht të fokusuara në drejtim të luftës kundër pandemisë. Gjithsesi ERRU në muajin Dhjetor 2020 organizoi një takim me zv. Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë z. Hantin Bonati posaçërisht për këtë çështje ku u mor angazhim nga ana e tij për të organizuar një takim tjetër me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor për të avancuar me hapa konkrete për zgjidhjen e këtij problemi.

Ecuria e rekomandimeve të tjera nuk ka patur zhvillime konkrete kjo sigurisht edhe si rezultat i situatës së krijuar nga Covid-19 ku një pjesë e konsiderueshme e institucioneve kanë qenë të angazhuar në këtë drejtim. Gjithashtu gjatë vitit 2020 siç u përmend edhe më lart në kapitujt e mësipërm, ERRU, nuk ka patur akses në përditësimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të saj përmes “Platformës Ndërinstitucionale Online”, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë.

4 Gjendja në Sektorin e Ujësjetës Kanalizime

4.1 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2020

Enti Rregullator i Ujit për të dytin vit radhazi, gjendjen e performancës së sektorit UK për vitin 2020, si pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së ERRU-së e ka realizuar me të dhënat tekniko-ekonomike e grumbulluara nga njësia e monitorimit pranë tij të cilat janë raportuar direkt nga shoqëritë Ujësjetës Kanalizime që operojnë në sektor. Theksohet fakti se të dhënat e raportuara nga Shoqëritë UK në këtë moment konsiderohen paraprake, por gjithsesi mjaft afër atyre që priten të certifikohen nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar deri në fund të muajit mars 2021.

Referuar kushtit të shprehur në ligjin nr. 8102 që raportimi mbi aktivitetin e ERRU-së dhe të gjendjes së performancës së sektorit duhet të jetë hartuar (botuar në hard copy) deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës e detyron Institucionin që të përdor këto të dhëna, të cilat garantojnë një saktësi mjaft më të madhe se metoda e mëparshme me ekstrapolim duke konsideruar të dhënat 9 mujore të marra nga AKUM.

ERRU në fund të qershorit të çdo viti harton dhe publikon edhe Raportin Vjetor të Performancës së Sektorit UK i cili jep një pasqyrë reale dhe të saktë të situatës në sektor si dhe analizon shoqëritë në veçanti ose sipas grupeve. Të dhënat e shoqërive në këtë rast ridërgohen përsëri pranë ERRU-së dhe janë të rakorduara me pasqyrat financiare të certifikuara nga ekspertët kontabël të autorizuar.

Për shoqëritë të cilat aplikojnë për nivel të ri tarifar, ERRU analizon në mënyrë të detajuar treguesit tekniko ekonomik dhe në vendimet respektive për tarifat e reja përcakton objektivat dhe rekomandimet të detyrueshme për tu realizuar nga shoqëritë UK të cilat monitorohen nga ERRU. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuar nga KKRR.

Tabela 8, jep nivelet e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2020 dhe tendencën e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2019 ndërsa në Aneks 4 jepen treguesit e performancës për secilën shoqëri në vete dhe sipas grupeve.

Tabela 8. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2019-2020

Nr.	Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2019	Viti 2020	Tendenda
1	Uji Pa të Ardhura	%	63.7	65.1	↘
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	107.1	103	↘
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	79.8	76.8	↘
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	95.8	89.9	↘
5	Niveli i Matjes	%	77.3	79.4	↗
6	Efienca e Stafit	(stafi/1000lidhje UK)	5.33	5.23	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	13.3	13.80	↗
8	Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	76.8	75.8	↘
9	Mbulimi me Kanalizime	%	51	50.8	=

Burimi: ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2020 tregojnë se gjendja në sektor në krahasim me vitin 2019 paraqet një përkeqësim në drejtim të treguesve të Ujit Pa të Ardhura, Mbulimit të Kostove Direkte të O&M, Normës së Arkëtimit si dhe treguesit Mbulimi me FU. Treguesi Mbulimi me kanalizime ka mbetur në të njëjtin nivel ndërkohë që ka përmirësim në treguesit e tjerë si Niveli i Matjes, Kohëzgjatja e FU, si dhe Eficenca e Staf/1000 lidhje UK.

Përgjithësisht përkeqësimi i gjendjes së sektorit shpjegohet me pasojat nga pandemia COVID 19, si dhe vazhdimësinë e atyre të tërmetit të fuqishëm të ndodhur në fund të vitit 2019.

Në përgjithësi, treguesit kryesorë të performancës kanë ndërruar nga njëri-tjetri dhe ndikimi pozitiv apo negativ i secilit tregues reflektohet dhe në treguesit e tjerë, gjë që ka sjell përkeqësimin në grup të pothuaj të gjithë treguesve të performancës.

Më poshtë jepet analiza e detajuar e ecuresë për secilin tregues kryesor të performancës.

"Uji Pa të Ardhura" (UPA), si një nga treguesit më të rëndësishëm në vitin 2020 është përkeqësuar pas një periudhe disa vjeçare stanjacioni, përkatësisht nga 65.1% në 63.7 % që ishte në vitin 2019. Ndikimin negativ në këtë tregues e ka dhënë rritja e konsiderueshme e ujit të prodhuar me 12.2 milion m³ ujë në një kohë që uji i faturuar ka mbetur pothuaj në të njëjtin nivel.

Rritje të konsiderueshme të ujit të prodhuara ka raportuar UK Durrës me 9,6 milion m³, UK Tiranë me 2.1 milion m³ ujë si dhe UK Kamëz me 1.6 milion m³ ujë. Ka dhe shoqëri të tjera që kanë rritje por në nivele më të ulëta. Siç shihet rritja kryesore prej 9,6 milion m³ ka ardhur nga UK Durrës me 9,6 milion m³ si rezultat i vënies në shfrytëzim të burimit të ri në Fushë Milot shtesë ndaj atyre ekzistuese nga burimet e Fushë Kuqes si rezultat i investimit nga Banka Botërore të një sistemi të ri ujësjellësi me prurje shtesë prej rreth 630 litra/sek. UK Durrës vazhdon ta mbajë në punë me kapacitet të plotë sistemin e furnizimit me ujë nga Fushë Kuqe, i cili në të ardhmen është planifikuar që të mbulojë zonën rurale dhe atë të Plazhit Durrës, por në zonën e kësaj të fundit akoma nuk është përfunduar investimi i rrjetit i cili do të bëjë të mundur që e gjithë Bashkia Durrës përfshirë dhe zonën e plazhit të furnizohet me ujë nga sistemi i ri i furnizimit me ujë nga Fushë Miloti.

Një tjetër element ndikues ku përfshihen edhe shumë shoqëri të tjera vjen kryesisht nga pasojat e tërmetit të fund vitit 2019, largimit të klientëve të cilët kanë shkëputur lidhjet me shoqëritë UK si dhe të pandemisë duke u shoqëruar kështu me ulje të faturimit kryesisht në zonat bregdetare ku ka patur rënie të numrit të pushuesve për këtë vit, si në rastin e UK Kavajë, por prodhimi i ujit ka vazhduar me të njëjtat nivele.

Në sektor operojnë shumë shoqëri që kanë nivel të mirë të këtij treguesi si UK Korçë, UK Lezhë, UK Pogradec, UK Maliq, UK Belsh dhe UK Kukës. Ky tregues është akoma mbi nivelin 70% në mjaft shoqëri të mëdha kryesisht të grupit të parë si UK Durrës, UK Fier, UK Elbasan, UK Berat Kuçovë dhe UK Kamëz.

Prej disa vitesh shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU Bilancin e Ujit, i cili është një instrument i rëndësishëm për evidentimin e humbjeve, vlerësimin e tyre si dhe orientimin e shoqërive për përmirësimin e treguesit "Uji Pa të Ardhura". ERRU i kushton një vëmendje të veçantë këtij dokumenti dhe e publikon atë çdo vit, gjithashtu kur shoqëritë aplikojnë për tarifa bëhet një analizë e veçantë e tij në të gjithë elementët.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" shpreh mbulimin e kostove direkte me të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë (përfshijë subvencionet). Në këto kosto përfshihen ato për personelin, energjinë, kimikatet dhe kosto të tjera sekondare që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen. Ky tregues për vitin 2020 është në vlerën e 103% nga 107.1% që ishte në vitin 2019. Një nga arsyt kryesore të kësaj situate është riorganizimi i shoqërive sipas Reformës Territoriale që me marrjen e zonave të reja në administrim nga shoqëritë UK ka sjellë një rritje të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Si rezultat i përkeqësimit të situatës financiare në mjaft shoqëri nga totali prej 57 shoqërish në sektor vetëm 9 prej tyre arrijnë të mbulojnë mbi 100% kostot O&M, nga 14 shoqëri të tilla që ishin në vitin 2019. Në 48 shoqëritë me performancë të dobët, 23 shoqëri performojnë nën nivelin 70% të këtij treguesi që me vështirësi mbulojnë pagat e personelit. Pjesa tjetër prej 25 shoqërive që mbeten janë në nivelet 71% deri 100% të këtij treguesi. Vetëm dy shoqëri në sektor, përkatësisht UK Tiranë dhe UK Ersekë, arrijnë të mbulojnë edhe kostot totale, në të cilat përfshihen dhe kostot e amortizimit dhe të interesave të kredive.

Në detaje kostot për sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve jepen në Tabelën 9

Tabela 9. Ecuria e Kostove dhe të Ardhurave krahasuar me vitin paraardhës

Nr.	Emërtimi <i>Kostot e Shërbimit UK</i>	Viti 2019 <i>në 000 lekë</i>	Viti 2020 <i>në 000 lekë</i>	Diferenca <i>në 000 lekë</i>
1	Kosto e punës	3,824,243	4,050,000	225,757
2	Kosto e materialeve	489,380	459,842	-29,538
3	Kosto e energjisë së konsumuar	2,678,804	2,680,000	1,196
4	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	374,373	502,121	127,748
5	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	930,163	950,334	20,171
7	Kosto të tjera operacionale	816,912	714,363	-102,549
	<i>Kostot Operim & Mirëmbajtjes</i>	9,113,875	9,356,660	242,785
1	Kostot e Amortizimit	2,592,402	2,400,849	-191,553
2	Kosto financiare, taksa tatime	888,167	483,600	-404,567
	<i>Kostot Totale</i>	12,594,444	12,241,109	-353,335
	<i>Të Ardhurat:</i>			
1	Nga shërbimet UK	9,181,340	9,463,752	+282,412
2	<i>Të ardhura të tjera lidhje rilidhje etj.</i>	582,112	186,536	-395,576
	<i>Të Ardhurat Totale</i>	9,763,452	9,650,288.00	-113,164
	<i>Niveli i Mbulimit të Kostove</i>			
	Mbulimi i Kostove të O&M	107%	103%	-4%
	<i>Mbulimi i Kostove Totale</i>	78%	79%	1%

Nga Tabela e mësipërme vërehet se Sektori për vitin 2020 e ka zhvilluar aktivitetin e tij duke shënuar një rritje të konsiderueshme të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes me rreth 242.8 milion lekë, ndërkohë që të ardhurat janë ulur me 113 milion lekë. Tendencë negative e tyre ka sjell përkeqësim në mbulimin e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes.

Në detaje konstatohet se rritjen më të madhe të kostove të O&M e përbëjnë kostot e punës (+225.7 milion) dhe kostot e riparimit dhe mirëmbajtjes (+127.7 milion). Kostot e energjisë dhe kostot e shërbimeve nga nënkontraktorët kanë shënuar një rritje të lehtë dhe të justifikuar.

Kostot e Punës rezultojnë të rritura në sektor për shkak të rritjes së numrit të punonjësve në shoqëritë UK me rreth 42 punonjës, si dhe të rishikimit të nivelit të pagave për stafet dhe ekipet manaxhuese të tyre.

Kostot e Riparimeve rezultojnë të rritura në vitin 2020 për shkak të defekteve të cilat rezultojnë më të larta në numër dhe që janë riparuar nga shoqëria. Pasojat e tërmeteve të fund vitit 2019 kanë patur impaktin e tyre në vazhdimësi duke rritur numrin e defekteve edhe për vitin 2020, të cilat kanë rritur konsiderueshëm kostot për këtë zë.

Kostot e Energjisë raportohen pothuajse në nivelin e vitit 2019 edhe pse vëllimi i ujit të prodhuar me ngritje mekanike rezulton të jetë rritur me 7.9 milion m³ ujë. Kjo për shkak të investimeve të kryera, në instalimin e pompave të reja me rendiment më të lartë, si dhe matësit në prodhim kanë dhënë efektin në reduktim të kostove njësi për 1 m³ ujë të prodhuar.

Kostot e Shërbimeve të Kontraktuara Në shërbimet e kontraktuara me të tretët një peshë të konsiderueshme zënë shërbimet e kontraktuara për rojet private. Për vitin 2020 janë 10 shoqëri që kryejnë pjesërisht ose tërësisht këtë shërbim nga shoqëri të licencuara. Në totalin e shërbimeve të kontraktuara vetëm UK Tiranë konsumon 610 milion lekë ose 68% të totalit prej 896 milion lekëve.

Kostot të Tjera Operacionale Përfshihen kostot e qerave për zyrat, vendimet gjyqësore, detyrimet ndaj institucioneve si ERRU, SHUKALB, Agjencive të Baseneve ujore etj. Ky zë shpenzimesh raportohet me ulje prej 102.5 milion lekë krahasuar me vitin 2019.

Kostot Kapitale ku përfshihen kostot e amortizimit dhe kostot financiare rezultojnë të ulura respektivisht me -191.5 milion dhe -404.5 milion lekë të cilat kanë sjellë paradoksisht në përmirësimin e treguesit të Mbulimi të Kostove Totale me 1%.

Të ardhurat nga Faturimi UK janë rritur me 282.4 milion lekë kryesisht nga influenza e nivelit të ri tarifar për 12 shoqëri që kanë implementuar ato gjatë vitit 2020, por dhe në një nivel të ulët nga rritja e nivelit të faturimit për sektorin UK me 48 mijë m³ ujë.

Nga ana tjetër të ardhurat nga shërbime të tjera lidhje, rilidhje kontratash, instalim matësa etj. janë ulur me 395.6 milion lekë, si rrjedhojë totali i të ardhurave rezulton me rënie në vlerën 113.1 milion lekë.

Theksohet se këto raportime janë operative-paprapake. Përfundimisht treguesi i Mbulimit të Kostove O&M dhe të Kostove Totale për vitin 2020 do të jepet në Raportin e Performancës së Sektorit Ujësjellës Kanalizime që publikohet në fund të muajit qershor 2021, ku ERRU i referohet të dhënave të Bilanceve Kontabël të certifikuara nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar duke iu nënshtruar një analize të thelluar, analitike dhe krahasimore.

"Norma e Arkëtimit" është një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës së shoqërive, që lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. ERRU konsideron dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimeve, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korrente (NAK). NAP në përllogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, përfshirë edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK përjashton këto të fundit.

Norma e Arkëtimit Korrente për të gjithë sektorin është përkeqësuar për vitin 2020 në 76.8 % nga 79.8% që ishte në vitin 2019. Ndikim negativ në rënie të nivelit të arkëtimeve ka dhënë edhe situata e krijuar nga Pandemia Covid-19 që presupozohet që ka rritur numrin e familjeve të kategorisë me ndihmë ekonomike, që normalisht nuk mund të paguajnë faturën e shërbimeve të FU dhe KUN. Gjithashtu, faktor tjetër negativ në mbledhjen e të ardhurave vlerësohet të jetë edhe nga pasojat e

tërmetit të cilat shkatërruan plotësisht mjaft banesa dhe pallate të cilat nuk faturohen akoma gjatë kësaj periudhe.

Gjithsesi në sektor ka shumë shoqëri që këtë tregues e kanë konstant ose dhe me përmirësim, si shoqëritë UK Tiranë, UK Vlorë, UK Berat Kuçovë, UK Pogradec, UK Malësi e Madhe, UK Lezhë, UK Vorë.

"Niveli i Matjes" është përmirësuar me 2.1%, krahasuar me vitin 2019 dhe ka arritur nivelin rreth 80% për të gjithë sektorin. Gjatë vitit janë instaluar rreth 35 mijë matësa uji. Në sektor ende raportohen 186, 717 klientë pa matësa nga të cilët 7,448 janë të kategorisë jo familjarë. Referuar VKM nr. 96, datë 21.02.2007 i detyron klientët jo familjarë (subjektet private) që të instalojnë ujëmatës me shpenzimet e tyre, por akoma rezulton i pazbatuar plotësisht.

Gjithsesi duhet të forcohet vëmendja për pajisjen e 100% të konsumatorëve me matësa, jo vetëm për faktin se çdo konsumator duhet të paguajë volumin real të ujit të konsumuar, por faturimi aforfe lë shteg për shpërdorimin e ujit nga konsumatorët për ujitje, veçanërisht ato të shtëpive private dhe zonave rurale. Kjo jep një impakt negativ edhe në treguesin tjetër të Uji Pa të Ardhura.

"Eficienca e Stafit" është 5.23 punonjës për 1000 lidhje UK kundrejt 5.33 që ishte në vitin 2019. Ky tregues luhet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK. Gjatë vitit 2020, numri i lidhjeve të ujit është rritur me rreth 21,256 lidhje dhe ai i kanalizimeve me rreth 22,869 lidhje dhe nga ana tjetër numri i stafit është rritur me 42 punonjës. Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje veçorive të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove dhe puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte që krijojnë përshtypjen e një treguesi të ulët të Eficiencës së Stafit.

Gjithsesi është evident dhe abuzimi me punësimet e pajustificuara, prandaj është e nevojshme që të thellohet analiza për vlerësimin real të këtij treguesi bazuar në organogramën përkatëse të shoqërisë dhe justifikimin e çdo pozicioni të punës në përputhje me përshkrimin e saj.

ERRU e ka në vazhdimësi prioritet të punës së saj analizën e thelluar të organigramës dhe numrit të stafit që operon shoqëria, duke justifikuar secilin pozicion të stafit të saj dhe me përshkrimin përkatës të punës. Veçanërisht, kjo analizë zhvillohet më tej kur shoqëria aplikon pranë ERRU për nivel të ri tarifor shoqëruar me një plan biznesi 5 vjeçar.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" lidhet direkt me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë që furnizohen konsumatorët. Ky tregues për vitin 2020 ka një tendencë të lehtë përmirësimi me 0.49 orë në ditë, si rezultat i investimeve me fonde të qeverisë qendrore nëpërmjet AKUM-it. Në sektor operojnë 8 shoqëri UK që kanë furnizim të pandërprerë dhe me cilësi të lartë 24/7 ditë. Pjesa dominuese e shoqërive ofrojnë në nivele relativisht të mira 10-15 orë në ditë. Gjithsesi, një vlerësim përfundimtar mbi performancën e sektorit do të jepet nga ERRU në Raportin e Performancës së Vitit 2020 ku është mundësia e një vlerësimi më të detajuar dhe të përjashtimit të ndonjë të dhëne evidente të pabesueshme.

"Mbulimi me Furnizimin me Ujë" si tregues është përkeqësuar nga 76,8% që ishte në vitin 2019 në 75.8% në vitin 2020. Kjo ka ardhur si rezultat i vazhdimit të procesit të riorganizimit të sektorit. Në disa bashki popullsia në zonën e juridiksionit rezulton të jetë rritur me 85 mijë banorë ndërsa ajo e shërbyer

me rreth 40 mijë. Kjo lidhet me marrjen nën administrim të shoqërive të shumë zonave të cilat më parë nuk janë shërbyer nga asnjë shoqëri UK. Gjithashtu, shumë shoqëri kanë raportuar shifra më të ulëta se vitin paraardhës që në total kjo ulje shkon rreth 23 mijë banorë. Pra efekti i zgjerimit të zonës së shërbimit mbetet 17 mijë banorë ose 20% e popullsisë së shtuar në zonën e juridiksionit.

Zgjerimi i zonës së shërbimit të shoqërive me zonat e bardha ose të pa shërbyera më parë influencën në përqendrimin "artificial" të treguesve të performancës për shoqërinë, zona të cilat kërkojnë investime të konsiderueshme fizike.

"Mbulimi me Kanalizime" është pothuajse konstant me atë të vitit 2019. Popullsia me shërbimin e KUN është rritur me rreth 35 mijë banorë si rezultat i futjes në skemën e këtij shërbimi të klientëve, si në shoqëritë UK Patos dhe UK Peqin, ku më parë ky shërbim ofrohej direkt nga bashkitë përkatëse. Ndikim në rritje të popullsisë së shërbyer dhe të numrit të klientëve me kanalizime kanë dhënë investimet e kryera nga buxheti i shtetit. Gjithsesi, krahas 2.2 milion banorëve që shërbehen nga shoqëria akoma rreth 216 mijë prej tyre e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike. Këto për momentin janë zgjidhje të pranueshme kur respektohen kushtet teknike për gropat septike. ERRU e ka theksuar dhe herë të tjera që nevojat për investime krahas shërbimit të FU duhet të orientohen edhe në drejtim të shërbimit me KUN me qëllim rregullimin dhe balancimin e dy shërbimeve.

4.2 Subvencionet dhe Debitë ndaj OSHEE-së

Qeveria Qendrore nëpërmjet AKUM-it gjatë vitit 2020 i ka shpërndarë shoqërive UK një vlerë totale subvencionesh prej 720 milion lekë, por ndryshe nga shpërndarja e vitit 2019 që një pjesë e tyre kishte karakter nxitës performance (incentiva), ato janë shpërndarë për të balancuar diferenca të kostove me të ardhurat me të cilat operojnë shoqëritë. Karakteristikë tjetër e procesit të subvencionimit ka qenë që një pjesë e tyre (21% e totalit) është alokuar për të mbuluar kostot e krijuara nga pandemia. Pjesa tjetër e subvencionit ka patur si destinacion pagesën e energjisë elektrike (21%), fonde shtesë për sigurimet shoqërore të punonjësve të shoqërive UK (42%), si dhe fonde të tjera shtesë për tatime e të tjera (14%). Një pasqyrë e detajuar sipas destinacioneve të mësipërme jepet në Aneks 5.

Nga tabela vihet re që subvencione kanë përfutur shoqëritë që nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot direkte të operim-mirëmbajtjes. Gjatë vitit 2020, nuk janë planifikuar dhe shpërndarë subvencione për 10 shoqëri, përkatësisht të bashkive Sarandë, Berat-Kuçovë, Lezhë, Tiranë, Korçë, Pogradec, Fier, Himarë, Librazhd dhe Klos.

Subvencionet e shpërndara për shoqëritë e bashkive të tjera konstatohet se paraqiten me mangësi të theksuara të pagesave të sigurimeve shoqërore të punonjësve të tyre si shoqëritë e bashkive Kavajë, Gjirokastrë, Tepelenë, Bulqizë, Patos, Poliçan, Tropojë, Këlcyrë dhe Has.

Nga tabela konstatohet gjithashtu se për energjinë elektrike paraqiten mjaft problematike dhe kanë marre vlera të konsiderueshme të subvencionit shoqëritë, Durrës, Vlorë, Kavajë, Shkodër, Lushnjë, Kamëz, Kurbin dhe Patos. Theksohet fakti se pamundësia e pagesës së faturës së energjisë elektrike ndaj OSHEE është një problem i bartur ku shuma e akumuluar në të kaluarën kalon vlerën e 70 milion euro. Zgjidhja e problemit të borxheve të bartura ndaj OSHEE-së duhet të trajtohet për zgjidhje përfundimtare nga qeveria qendrore.

ERRU do të rrisë kërkesat në drejtim të hartimit dhe zbatimit të planeve të efikasitetit të energjisë në veçanti për shoqëritë e mësipërme dhe kur aplikojnë për tarifa të reja, ku energjia elektrike është pjesa më e rëndësishme e kostove të cilat duhet të jenë të justifikuar.

5 Situata në Zbatim të Reformës në Sektorin e Ujit

Kanë kaluar 5 vjet nga miratimi i VKM -së për reformën në sektorin UK dhe ende ka shoqëri që nuk e kanë përfunduar riorganizimin. Shoqëritë ekzistuese dhe ato të reja të krijuara, u përballen me sfida dhe vështirësi në drejtim të procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të asetëve dhe më pas regjistrimi i tyre në QKB, si rezultat i mungesës së dokumentacionit përkatës nga ish komunat. Pajisja me Akt Miratime Higjieno Sanitare përfshirë dhe zonën e shtuar rurale ka qenë veçanërisht problem për shoqëritë UK pas riorganizimit, për arsytet e trajtuara në kapitullin e licencimit.

Aktualisht, shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin në të gjithë territorin administrativ të bashkive përkatëse, por jo të gjitha kanë arritur të plotësojnë kërkesat sipas procesit të parashikuar të riorganizimit. Ky proces parashikonte gjithashtu që brenda 3 muajve nga përfundimi i tij shoqëritë duhet të aplikojnë pranë Entit Rregullator të Ujit për licencim dhe miratimin e tarifave të reja për të gjithë zonën e re të shërbimit, gjë e cila ka qenë pengesë për këto shoqëri për të aplikuar pranë ERRU-së për tarifa të reja.

ERRU vazhdon të ndjek nga afër dhe të inkurajojë procesin e riorganizimit dhe të licencimit të të gjithë shoqërive UK në përputhje me riorganizimin e tyre sipas reformës. Deri më tani, kanë përfunduar riorganizimin dhe janë licencuar nga ERRU sipas reformës 39 nga 57 shoqëri UK, të cilat jepen në mënyrë të detajuar në Aneks 3.

Në fund të vitit 2019, për përshpejtimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, MIE përpiloi një qasje që është përfshirë në projekt ligjin e ri për sektorin e ujit që akoma nuk është aprovuar. Qasja e propozuar për shëndoshjen e sektorit të ujësjellës kanalizimeve bazohet në ndarjen në dy kategori të shoqërive UK, përkatësisht në ato që operojnë duke mbuluar kostot e O&M dhe në ato të cilat kanë nevojë për subvencionim nga Qeveria Qendrore. Propozimi merr në konsideratë shoqëritë e kategorisë që kanë nevojë për subvencion nga qeveria qendrore dhe propozon një Plan Veprimi për to me një shtrirje kohore zbatimi rreth dy vjeçare.

Theksohet fakti se janë 48 nga 57 shoqëri UK që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M. Për këtë kategori të shoqërive, në princip, qasja propozon agregimin e tyre “të detyruar” ku qeveria bëhet aksionere me investimet fizike që do të investojë në shoqëri, përndryshe nuk i kryen financimet për investime fizike dhe nuk akordon subvencionet për të mbuluar kostot e O&M. Kjo qasje përgjithësisht synon krijimin e shoqërive të agreguara përgjithësisht gjigande që do të menaxhohet nga një staf qendror (Struktura e Kompetencave të Përbashkëta ose SKP). Gjithashtu për shoqëritë që nuk përmbushin treguesit e performancës në mënyrë të vazhdueshme qasja presupozon futjen në veprim të Operatorit të Alternativës së Fundit, i cili merr përsipër manaxhimin e shoqërisë për një periudhë të caktuar deri në përmirësimin e treguesve të performancës dhe më tej ja kthen përsëri shoqërisë së mëparshme UK.

Gjithsesi eksperiencia ndërkombëtare dhe ajo e vendeve me kushte të përafërta me tonat nuk njeh ndonjë shembull suksesi ku sektori është agreguar pothuajse në mënyrë të menjëhershme.

Shëndoshja afatshkurtër financiare e sektorit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit pritet të vijë kryesisht nga reduktimi i fuqisë punëtore dhe rritja e normës së arkëtimit. Lënia në njëfarë mënyre, e bashkive jashtë procesit kompromenton sidomos faktorin e dytë (normën e arkëtimit), ku roli i bashkisë është mjaft i rëndësishëm në mbështetje kundër debitorëve dhe abuzuesve.

Studimi i bëshmërisë i vitit 2008 për agregimin e sektorit të ujit në Shqipëri, financuar nga Banka Botërore, ka konkluduar se agregimi duhet realizuar mbi baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Procesi duhet të jetë diskret, gradual, mbështetje me fonde (incentiva) dhe me angazhim të fortë institucional të pushtetit qendror dhe atij vendor.

ERRU për vazhdimësinë e reformës në sektorin e ujit dhe përmirësimin e situatës në sektor i qëndron rekomandimit të saj për nevojën e agregimit të sektorit. Për këtë duhet angazhimi i fortë institucional i pushtetit qendror dhe atij vendor ku fillimisht, të realizohen 2-3 agregime të suksesshme, pas një studim anketimi të gjithë bashkive të vendit, me pritshmëri pozitive sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore”.

6 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2021

- ❖ Në rast të mos aprovimit të projekt-ligjit të ri për sektorin UK të ndjekë procedurat për rishikimin e Ligjit Nr. 8102 për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të sektorit.
- ❖ Përfundimin e punës për rishikimin dhe hartimin e "Metodologjisë së vendosjes së tarifave për shërbimin e UK", për përfundimin e së cilës u bë pengesë pandemia e COVID 19.
- ❖ Të synohet me mbështetjen e donatorëve hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK, përfshirë dhe trajnimet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim.
- ❖ Të nxisë organizimin e një seminari "Mbi Agregimin e Sektorit" me ndihmën edhe të ekspertëve të huaj dhe vendas, SHUKALB etj. për të argumentuar në detaje për avantazhet si ekonomi e shkallës dhe domosdoshmërinë e agregimit të sektorit përfshirë dhe eksperiencën të suksesshme ndërkombëtare të ngjashme.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues që të fillojë realizimi i 2-3 shembujve pilot agregimi të suksesshëm të shumë shoqërive UK në sektor, si një nga drejtimet kryesore të strategjisë për përmirësimin e performancës në sektor mjaft të fragmentarizuar me 57 shoqëri UK.
- ❖ Të luajë një rol nxitës dhe ndërgjegjësues për rishikimin e nën akteve ligjore që lidhen me Akt Miratimin Higjieno Sanitar që duhet të përfitojnë Shoqëritë UK për tu pajisur me Licencë nga ERRU.
- ❖ ERRU të vazhdojë përpjekjet për forcimin e rolit të ERRU deri në pozita institucionale vendimmarrje për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve ndaj shoqërive UK që shpesh mbajnë qëndrim arbitrar.
- ❖ Të rrisë kapacitetet profesionale të stafit me një planifikim të drejtë të trajnimit të tyre me burime të brendshme dhe të jashtme duke shfrytëzuar edhe mundësitë nga bashkëpunimet e gjëra dhe bilaterale me rregullatorët Evropianë të sektorit të ujit.
- ❖ Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.
- ❖ Në vazhdimësi të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të forcojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe aktorëve të tjerë kryesorë të sektorit të ujit në mbështetje të strategjisë së reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK

7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit

- Hartimi i një udhëzuesi dhe model i unifikuar i Planit 5 Vjeçar të Biznesit për Shoqëritë UK nga ERRU, si dokumenti bazë në mbështetje të justifikimit të tarifave të propozuara nga Shoqëritë UK, dhe si instrument i domosdoshëm për përmirësimin e manaxhimit të shoqërive në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tyre.
- Hartimi i akteve të nevojshme nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektimeve Higjeno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i nënakteve të mësipërme do të shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rriskut të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, si një domosdoshmëri për zgjidhjen e problemit të licencimit të shoqërive UK.
- Është tashmë e njohur ideja dhe domosdoshmëria e procesit të agregimit të Shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës për përmirësimin e performancës së sektorit dhe nisja e procesit bazuar në principin “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar fillimisht që të realizohen 2-3 agregime të suksesshme, ku ERRU duhet të para vlerësojë tarifat e agreguara në rastet e seleksionuara për agregim.
- Si një element kyç për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive UK, të thellohet procesi i hartimit të Kontratave të Performancës ndërmjet AKUM dhe Bashkive bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës aktuale dhe ato si objektiva të vlerësuar realisht, proces në monitorimin e të cilave duhet të përfshihet edhe ERRU. Realizimet e vlerësuara të këtyre kontratave të shërbejë si kriter bazë edhe për shpërndarjen e subvencioneve nga qeveria qendrore për shoqëritë UK.

Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2020

Tabela 1. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje dhe shoqëritë që janë ende në proces

Nr.	Shoqëritë që kanë aplikuar	Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR			
		Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi Ligjor	Ndryshim Drejtuesi Teknik	Ndryshim Zone Shërbimi
1	Sh.A.UK Belsh	X			
2	Sh.A.UK Bulqizë	X			
3	Sh.A.UK Fier				X
4	Sh.A.UK Finiq		X		
5	Sh.A.UK Konispol		X	X	
6	Sh.A.UK Kukës	X			
7	Sh.A.UK Malësi e Madhe	X			
8	Sh.A.UK Mirditë	X			
9	Sh.A.UK Patos				X
10	Sh.A.UK Pogradec		X		
11	Sh.A.UK Tepelenë			X	
12	Sh.A.UK Tropojë		X	X	
13	Sh.A.UK Ura - Vajgurore	X			
14	Sh.A.UK Vlorë		X		
15	Sh.A.UK Vorë		X		
16	Sh.A.UK Vorë			X	
17	Sh.A.UK Vorë	X			
18	Sh.A.UK Mat		X		
19	Sh.A.UK Rrogozhine			refuzim	
20	Sh.A.UK Tiranë	X	X		
21	Sh.A.UK Selenicë	X			
Nëntotali		9	8	5	2
Totali		24			

Burimi ERRU

Shoqëria sh.a UK Tiranë dhe UK Selenicë janë në proces për rinovim licence

Tabela 2. Situata e Gjendjes së Licencimit të Shoqërive UK - 2020

Nr.	Me licencë të vlefshme	Në proces rinovimi Mbarim afati, ndryshim drejtuesi ligjor/teknik, ndryshim zone shërbimi, shoqëri e re	Me Licencë të pavlefshme dhe që nuk kanë aplikuar	Asnjëherë të pajisur me licencë
1	Sh.a. UK Gjirokastrër	Sh.a. UK Tiranë	Sh.a. U Divjakë	Sh.a. UK Kamëz
2	Sh.a. UK Devoll	Sh.a. U Selenicë	Sh.a. UK Has	Sh.a. UK Klos
3	Sh.a. UK Lezhë		Sh.a. UK Lushnje	Sh.a. UK Pustec
4	Sh.a. UK Tepelenë			
5	Sh.a. UK Dibër			
6	Sh.a. UK Korçë			
7	Sh.a. UK Durrës			
8	Sh.a. UK Mat			
9	Sh.a. UK Delvinë			
10	Sh.a. UK Berat - Kuçovë			
11	Sh.a. UK Patos			
12	Sh.a. UK Kurbin			
13	Sh.a. UK Ura Vajgurore			
14	Sh.a. UK Librazhd			
15	Sh.a. U Gramsh			
16	Sh.a. UK Malësi e Madhe			
17	Sh.a. UK Kukës			
18	Sh.a. UK Vorë			
19	Sh.a. UK Kolonjë			
20	Sh.a. UK Pogradec			
21	Sh.a. UK Krujë			
22	Sh.a. UK Poliçan			
23	Sh.a. UK Vau i Dejës			
24	Sh.a. UK Belsh			
25	Sh.a. UK Maliq			
26	Sh.a. UK Cërrik			
27	Sh.a. UK Vlorë			
28	Sh.a. UK Skrapar			
29	Sh.a. UK Shkodër			
30	Sh.a. UK Roskovec			
31	Sh.a. UK Tropojë			
32	Sh.a. UK Sarandë			
33	Sh.a. UK Libohovë			
34	Sh.a. UK Rrogozhinë			
35	Sh.a. UK Dropull			
36	Sh.a. UK Kavajë			
37	Sh.a. UK Himarë			
38	Sh.a. UK Finiq			
39	Sh.a. UK Konispol			
40	Sh.a. UK Elbasan			
41	Sh.a. U Këlcyrë			
42	Sh.a. UK Mallakastër			
43	Sh.a. UK Fushë Arrëz			
44	Sh.a. UK Përmet			
45	Sh.a. UK Peqin			
46	Sh.a. UK Pukë			
47	Sh.a. UK Fier			
48	Sh.a. U Bulqizë			
49	Sh.a. UK Mirditë			
Nëntotali				
	49	2	3	3
Totali 57				

Burimi: ERRU

Aneks 2 - Tarifat aktuale për Shërbimin e Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujërave të Ndotura

Nr	Lloji i shoqërisë	Emërtimi	2020								
			Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm			Shërbimi i largimit të ujërave të ndotur			Tarifë fikse		
			Tarifë variabël			Tarifa variabël					
Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat			
1	UK	Belsh									
2	UK	Berat-Kuçovë	50	130	130	14	24	24	100	200	200
	Nj. Administrative	Roshnik	40	130	130	14	24	24	100	200	200
3	U	Bulqizë	17	55	75				100	100	100
	Nj. Administrative	Krastë	30	80	100	7	10	15			
4	U	Cërrik									
5	UK	Delvinë	58	120	120	18	35	35	167	200	200
6	UK	Devoll	38	100	110				50	50	50
7	UK	Dibër	27	65	85						
8	U	Divjakë									
9	UK	Dropull	23								
10	UK	Durrës	70	120	130	50	60	60	150	150	150
11	UK	Elbasan	38	115	130	8	25	30			
	Nj. Administrative	Elbasan Fshat	38	120	120				120	120	120
12	UK	Fier	52	105	125	13	18	20	200	200	200
13	UK	Finiq									
14	UK	Fushë Arrëz									
15	UK	Gjirokastrë	46	133	138	11	18	18	100	100	100
	Nj. Administrative	Cepo, Antigoni, Lazarat, Lunxhëri, Odrie, Picar	25	60	60	-	-	-	80	-	-
16	U	Gramsh	32	90	90				60	150	180
17	U	Has									
18	UK	Himarë	55	100	100	30	50	50	200	200	300
19	UK	Kamëz									
20	UK	Kavajë	38	80	100	15	20	20			
21	U	Këlcyrë									
22		Klos									
23	UK	Kolonjë	110	10	13	18	100	100	100	110	10
24	UK	Konispol									
25	UK	Korçë	72	117	140	42	64	64	140	140	140
	Nj. Administrative	Mollaj, Bulgarec	38	110	100				100	100	100
	Nj. Administrative	Voskop, Komuna Vithkuq, Bulgarec (të tjera)	28	110	100				100	100	100
	Nj. Administrative	Drenovë	28	110	100				100	100	100
	Nj. Administrative	Voskopojë	28	110	100				100	100	100
26	UK	Krujë	35	80	100	8	12	12	100	200	200
27	UK	Kukës									
28	UK	Kurbin	30	80	120				50	50	50
29	UK	Lezhë	58	135	145	18	22	27	200	200	200
30		Libohovë									
31	UK	Librazhd-Përrenjas	42	100	100	15	25	26	100	100	100
	Nj. Administrative	Qukës, Rrajcë, Stravaj, Stebleve, Hotolisht, Lunik, Orenje, Polis, Qender Librazhd	26	60	60	-	-	-	100	100	100
32	UK	Lushnje									
	Nj. Administrative	Lushnje, Kolonjë, Fier-Shegan, Dushk	62	130	130	17	21	24	100	200	200
	Nj. Administrative	Bubullimë, Allkaj, Krutje, Golem, Ballagat, Hysgjokaj, Karbunarë	62	110	110	17	21	24	100	100	100
	U	Malësi e Madhe	50	120	120	12	15	15	167	167	167
34	UK	Maliq									
	Nj. Administrative	Maliq, Libonik, Pojan, Vreshtas, Parg (Zona Fushore)	45	100	105				54/50 *	54/50 *	54/50 *
	Nj. Administrative	Maliq, Libonik, Parg, Gore, Moglicë (Zona Malore)	22.5	100	105				27	54	54
35		Mallakastër									
36	UK	Mat	23	60	80	2	4	6			
37	UK	Mirditë	30	100	115	10	15	15			
	Nj. Administrative	Rubik	30	70	100	7	10	15			
38	U	Patos	50	100	100						
39	UK	Peqin	48	120	120	12	16	16	100	200	200
40	UK	Përmet	40	110	120				100	100	200
41	U	Pogradec									
	Nj. Administrative	Pogradec Buçimas	60	111	111	30	40	40	200	300	300
	Nj. Administrative	Udenisht, Cerravë, Proptisht, Velçan, Trebinjë, Dardhas	30	100	100	15	30	30	100	100	100
42	U	Polican	50	100	110	12	15	15	100	100	100
43	UK	Pukë	35	130	140	8	16	16	100	100	100
44		Pustec									
45	UK	Roskovec	52	105	125	15	20	20	100/50*	100/50*	100/50*
46	UK	Rrogozhinë	48	90	100	10	12	12	50	100	100
47	UK	Sarandë	52	138	138	20	31	31	150	150	150
48	U	Selenicë	30	80	100						
49	UK	Shkodër	40	110	110	15	20	20	100	100	100
50	UK	Skrapar	35	100	110	10	10	10	100	100	100
51	UK	Tepelenë	33	100	120	12	20	20	90	400	250
52	UK	Tiranë	65	140	155	11	30	35	200	200	200
53	U	Tropojë									
	Nj. Administrative	Bajram Curri	40	80	80	13	22	22	100	100	100
	Nj. Administrative	Bujan, Bytyc, Fierzë, Lluga, Margega, Tropojë, Lekbibaj	30	80	80	-	-	-	100	100	100
54	UK	Ura Vajgurore	40	90	100						
55	UK	Vau i Dejës	42	120	120	7	20	20	83	167	167
56	UK	Vlorë	45	100	100	15	25	25	100	150	150
57	UK	Vorë	65	140	155	15	30	35	200	200	200

Janë operatorë që aplikojnë tarifa të pamiratuara nga ERRU por që i ka përcaktuar vetë shoqëria

Janë operatorë që nuk janë licencuar ende pas riorganizimit dhe aplikojnë tarifa të pamiratuara nga ERRU

* Janë tarifa fikse të ndara për ujë dhe kanalizime

Aneks 3 - Shoqëritë e riorganizuara dhe të licencuara sipas reformës

Nr.	Shoqëri të Licencuara sipas Reformës				
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1	Sh.a UK Kukës	Sh.a UK Gjirokastrë	Sh.a UK Libohovë	Sh.a UK Pukë	Sh.a UK Fier
2	Sh.a UK Vorë	Sh.a U Gramsh	Sh.a UK Dropull	Sh.a UK Elbasan	Sh.a UK Bulqizë
3	Sh.a UK Belsh	Sh.a UK Korçë	Sh.a UK Konispol		
4	Sh.a UK Malësi e Madhe	Sh.a UK Krujë	Sh.a UK Tropojë		
5		Sh.a UK Mirditë	Sh.a UK Vlorë		
6		Sh.a U Poliçan	Sh.a UK Rrogozhinë		
7		Sh.a UK Berat Kuçovë	Sh.a UK Kavajë		
8		Sh.a UK Devoll	Sh.a UK Sarandë		
9		Sh.a UK Maliq	Sh.a UK Ura Vajgurore		
10		Sh.a UK Patos			
11		Sh.a UK Skrapar			
12		Sh.a UK Vau Dejës			
13		Sh.a UK Tepelenë			
14		Sh.a UK Delvinë			
15		Sh.a UK Lezhë			
16		Sh.a UK Pogradec			
17		Sh.a UK Shkodër			
18		Sh.a UK Cërrik			
19		Sh.a UK Roskovec			
20		Sh.a UK Mat			
21		Sh.a UK Lushnje			
22		Sh.a UK Librazhd			
Nëntotali					
	4	22	9	2	2
Totali 39					

Burimi ERRU

Aneks 4 - Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2020

Grupimi	Shoqëritë	Mbulim i koston totale	Mbulimi i koston Direkte O&M	Niveli i matjes	Norma e arkëtimit e përgjithshme	Norma e Arkëtimit Korente	Efienca e stafit U+K	Humbjet, Uji pa të ardhura	Mbulimi me kanalizime	Mbulimi me ujësjellës	Furnizimi me ujë
Grupi 1	UK Tiranë	131%	153%	89%	89%	85%	2.55	60%	90%	96%	15.44
	UK Durrës	72%	83%	95%	88%	71%	5.16	80%	57%	94%	9
	UK Vlorë	53%	72%	60%	117%	96%	4.18	79%	62%	91%	11.28
	UK Elbasan	69%	91%	74%	66%	39%	4.63	74%	59%	73%	12.5
	UK Fier	65%	79%	67%	75%	36%	5.35	76%	38%	63%	22
	UK Shkodër	49%	85%	70%	91%	67%	5.97	69%	44%	56%	21.7
	UK Korçë	83%	192%	99%	94%	81%	2.47	31%	65%	90%	24
	UK Berat Kuçovë	90%	136%	75%	104%	91%	4.85	72%	54%	71%	14
	UK Kavajë	40%	53%	41%	70%	57%	7.29	57%	62%	97%	10
	UK Lushnje	53%	75%	95%	81%	55%	5.61	74%	38%	75%	5
	UK Sarandë	59%	96%	95%	91%	72%	4.97	53%	79%	108%	10
Grupi 2	UK Kamëz	58%	93%	85%	121%	93%	3.33	64%	100%	48%	4
	UK Lezhë	53%	132%	86%	93%	90%	4.29	38%	60%	72%	21
	UK Pogradec	54%	108%	89%	95%	86%	5.89	40%	51%	86%	21.3
	Totali Grupi I-rë 14	84%	112%	83%	90%	78%	3.94	68%	67%	83%	13.75
	UK Maliq	69%	70%	90%	83%	73%	5.64	36%	24%	65%	14
	UK Gjirokastrë	77%	96%	60%	73%	41%	8.62	48%	40%	100%	13
	UK Dibër	94%	96%	60%	83%	49%	6.00	57%	17%	37%	8
	UK Devoll	81%	93%	100%	68%	43%	5.40	23%	0%	86%	22
	UK Cërrik	67%	70%	82%	117%	82%	6.14	69%	27%	59%	22
	UK Belsh	65%	69%	92%	73%	58%	9.74	10%	17%	95%	18
	UK Kurbin	37%	40%	22%	72%	67%	9.17	54%	37%	46%	4
Grupi 3	UK Kukës	91%	124%	37%	63%	35%	6.63	35%	40%	75%	8.4
	UK Librazhd	92%	108%	99%	90%	57%	4.98	53%	21%	29%	24
	UK Mat	86%	100%	73%	89%	75%	5.60	44%	46%	84%	12
	UK Divjakë	45%	47%	97%	33%	17%	11.55	52%	0%	55%	6
	UK Krujë	46%	61%	79%	105%	58%	6.88	62%	26%	43%	8
	UK Himarë	58%	81%	92%	125%	69%	6.75	57%	18%	91%	16
	U Patos	22%	23%	33%	92%	57%	17.10	54%	52%	73%	12
	UK Mallakastër	44%	53%	60%	74%	60%	15.61	59%	21%	77%	11
	U Gramsh	81%	97%	83%	94%	84%	8.87	39%	0%	90%	24
	UK Rrogozhinë	51%	72%	95%	90%	69%	7.54	62%	8%	66%	9
	U Bulqizë	75%	81%	23%	101%	78%	10.28	43%	0%	56%	19
Grupi 3	UK Malësi e Madhe	72%	89%	67%	95%	73%	6.45	52%	2%	65%	11.2
	UK Tepelenë	34%	45%	69%	109%	85%	8.46	34%	39%	55%	24
	UK Përmet	42%	72%	92%	88%	85%	12.58	38%	0%	96%	24
	UK Dropull	30%	44%	19%	110%	87%	7.02	40%	1%	100%	10
	UK Vorë	89%	90%	78%	96%	94%	12.02	66%	48%	49%	8
	U Selenicë	48%	49%	9%	75%	73%	11.28	71%	0%	54%	7
	UK Ersekë	138%	140%	40%	75%	71%	4.31	24%	82%	100%	21
	UK Ura Vajgurore	32%	43%	94%	95%	70%	9.50	60%	13%	51%	10
	UK Mirditë	54%	91%	69%	53%	44%	11.11	48%	40%	54%	15
	UK Peqin	49%	53%	97%	99%	84%	22.80	63%	0%	64%	20
	UK Tropojë	87%	121%	89%	55%	43%	10.35	29%	29%	56%	12
Grupi 3	UK Vau Dejës	46%	54%	76%	42%	44%	9.53	66%	6%	57%	9
	UK Roskovec	36%	62%	85%	119%	87%	15.76	65%	0%	50%	5
	UK Skrapar	50%	55%	38%	77%	62%	9.16	52%	46%	93%	3
	UK Delvinë	68%	81%	59%	83%	81%	7.11	43%	38%	89%	6
	UK Poliçan	64%	70%	66%	83%	76%	8.10	46%	68%	69%	24
	Totali Grupi II-të 34	57%	68%	69%	85%	67%	8.62	52%	22%	63%	12.75
	UK Finiq	67%	76%	57%	66%	41%	11.29	77%	0%	44%	7
	UK Konispol	33%	65%	98%	112%	88%	10.81	36%	0%	95%	20
	U Klos	57%	66%	27%	76%	61%	15.76	20%	0%	31%	9
	UK Pukë	57%	85%	59%	105%	90%	9.59	36%	25%	39%	24
	UK Këlcyrë	21%	22%	93%	60%	47%	20.08	85%	0%	47%	10
	U Has	31%	39%	72%	108%	69%	20.25	59%	0%	69%	8
Grupi 3	UK Libohovë	31%	33%	2%	60%	54%	11.17	47%	0%	100%	13
	UK Fushë Arrëz	31%	65%	46%	87%	81%	8.76	52%	35%	44%	24
	UK Pustec	26%	34%	100%	83%	75%	12.79	44%	24%	52%	10
	Totali Grupi III-të 9	38%	51%	62%	106%	78%	13.02	60%	0%	53%	13.89
Gjendja në sektor		79%	103%	79.4%	89.9%	76.8%	5.23	65.1%	50.8%	75.8%	13.79

Burimi ERRU

- Të dhënat e publikuara janë operative pasi ato përfundimtare të certifikuara jepen në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2020 që publikohet nga ERRU në muajin Qershor të vitit pasardhës, pas miratimit të bilanceve financiare nga ekspertët kontabël.

Aneks 5 - Subvencionet nga Qeveria për Shoqëritë UK, Viti 2020

Nr.	Emërtimi	Fondi për COVID	Fondi për Energji	Fondi Shtese për Sigurime Shoqërore	Fondi Shtesë për Tatime të tjera	Totali	Ndaj Totalit (ne %)	Mbulimi i Kostove O&M (ne %)
Grupi I-rë								
1	Tiranë	0	0	0	0	0	0%	153%
2	Durrës	0	30,175,200	0	0	30,175,200	4%	83%
3	Vlorë	0	30,429,000	0	420,000	30,849,000	4%	72%
4	Elbasan	0	3,884,900	0	40,000	3,924,900	1%	91%
5	Fier	0	0	0	0	0	0%	79%
6	Shkodër	0	7,207,900	0	75,541,142	82,749,042	11%	85%
7	Korçë	0	0	0	0	0	0%	192%
8	Berat - Kuçovë	0	0	0	0	0	0%	136%
9	Kavajë	0	12,354,100	7,807,307	195,905	20,357,312	3%	53%
10	Lushnje	0	5,608,100	0	90,000	5,698,100	1%	75%
11	Sarandë	0	0	0	0	0	0%	96%
12	Kamëz	0	5,836,700	161,806	0	5,998,506	1%	93%
13	Lezhë	0	0	0	0	0	0%	132%
14	Pogradec	0	0	0	0	0	0%	108%
Nëntotal G I-rë		0	95,495,900	7,969,113	76,287,047	179,752,060	25%	112%
Grupi II-të								
1	Maliq	0	1,040,400	0	0	1,040,400	0%	70%
2	Gjirokastrë	0	0	10,162,604	247,932	10,410,536	1%	96%
3	Dibër	5,500,000	0	5,021,957	2,786,648	13,308,605	2%	96%
4	Devoll	1,200,000	0	0	0	1,200,000	0%	93%
5	Cërrik	4,000,000	2,758,800	7,146	0	6,765,946	1%	70%
6	Belsh	5,000,000	1,962,500	0	0	6,962,500	1%	69%
7	Kurbini	6,000,000	8,475,900	5,201,986	22,101	19,699,987	3%	40%
8	Kukës	3,500,000	0	62,241,758	21,607,500	87,349,258	12%	124%
9	Librazhd	0	0	0	0	0	0%	108%
10	Mat	3,000,000	0	197,782	590	3,198,372	0%	100%
11	Divjake	2,500,000	2,600,400	875,610	409,382	6,385,392	1%	47%
12	Krujë	10,000,000	2,063,500	3,080,057	328,193	15,471,750	2%	61%
13	Himarë	0	0	0	0	0	0%	81%
14	Patos	18,500,000	12,346,100	32,894,767	2,245,437	65,986,304	9%	23%
15	Mallakastër	10,000,000	3,915,100	129,236	10,000	14,054,336	2%	53%
16	Gramsh	2,000,000	0	0	0	2,000,000	0%	97%
17	Rrogozhinë	6,000,000	2,374,300	560,173	0	8,934,473	1%	72%
18	Bulqizë	2,400,000	0	12,739,169	725,910	15,865,079	2%	81%
19	Malësi e Madhe	0	0	7,760,403	580,670	8,341,073	1%	89%
20	Tepelenë	1,500,000	0	22,760,142	114,316	24,374,458	3%	45%
21	Përmet	1,000,000	0	0	0	1,000,000	0%	72%
22	Dropull	0	0	20,000	0	20,000	0%	44%
23	Vorë	5,000,000	1,685,600	0	0	6,685,600	1%	90%
24	Selenice	4,000,000	1,205,000	446,712	10,721	5,662,433	1%	49%
25	Erseke	3,000,000	0	0	0	3,000,000	0%	140%
26	Ura Vajgurore	4,300,000	2,909,100	0	191	7,209,291	1%	43%
27	Mirditë	4,500,000	0	5,675,474	3,922,976	14,098,450	2%	91%
28	Peqin	9,000,000	3,773,500	811,248	0	13,584,748	2%	53%
29	Tropojë	2,000,000	0	46,572,151	960,000	49,532,151	7%	121%
30	Vau i Dejës	7,000,000	1,063,400	751,522	9,007	8,823,929	1%	54%
31	Roskovec	500,000	707,100	0	20,000	1,227,100	0%	62%
32	Skrapar	5,500,000	1,022,800	2,104,857	211,027	8,838,684	1%	55%
33	Delvinë	4,800,000	361,000	0	0	5,161,000	1%	81%
34	Poliçan	2,000,000	675,100	31,677,546	2,458,165	36,810,811	5%	70%
Nëntotal G-II-të		133,700,000	50,939,600	251,692,306	36,670,766	473,002,666	66%	68%
Grupi III-të								
1	Finiq	0	0	324,976	0	324,976	0%	76%
2	Konispol	0	2,026,500	0	0	2,026,500	0%	65%
3	Klos	0	0	0	0	0	0%	66%
4	Pukë	2,500,000	0	2,120,697	869,026	5,489,723	1%	85%
5	Këlcyrë	3,500,000	711,000	8,350,515	360,000	12,921,515	2%	22%
6	Has	5,000,000	827,000	21,528,253	3,442,394	30,797,647	4%	39%
7	Libohovë	2,500,000	0	2,827,202	1,933	5,329,135	1%	33%
8	Fushë Arrëz	1,700,000	0	2,911,212	742,486	5,353,698	1%	65%
9	Pustec	1,100,000	0	2,275,732	1,626,348	5,002,080	1%	34%
Nëntotal G III-të		16,300,000	3,564,500	40,338,587	7,042,187	67,245,274	9%	51%
TOTALI		150,000,000	150,000,000	300,000,000	120,000,000	720,000,000	100%	103%

Burimi: AKUM

Aneks 6 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit" (ligji nr. 120/2016);
- Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligj nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë (Kodi i Procedurës Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar (ligji nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" (ligji nr. 9584);
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" (ligji nr. 8480).
- VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për Miratimin e Kategorive të Licencimit dhe Procedurave të Aplikimit për Licencë të Operatorëve që Ushtrjnë Veprimtarinë në Sistemet e Furnizimit me Ujë, të Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura".
- Rregullore e Licencimit "Për Procedurat e Dhënies dhe Rinovimit të Licencave Profesionale për Subjektet Juridike e Fizike që Ushtrjnë Veprimtari në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura", miratuar me Vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009, e ndryshuar.
- Vendimi nr. 39, datë 09.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".
- Vendimi nr. 40, datë 09.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura".
- Vendimi nr. 41, datë 09.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura".
- Vendimi nr. 42, datë 09.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura".



Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.